

SHABAN DEMIRAJ

VEÇORITË E LAKIMIT NË SISTEMIN PËREMËROR TË GJUHËS SHQIPE

(Vështruar historikisht)

1. Sistemi përemëror i gjuhës shqipe, siç dihet, paraqitet sot me një laryshi tipesh të ndryshme strukturore dhe lakimore, që janë përfutur gjatë evolucionit të tij historik. Po të krahasohet me sistemet përemërore të atyre gjuhëve indoevropiane, që janë të dokumentuara me shkrim që heret, sistemi përemëror i shqipes na paraqitet pothuaj krejt i riorganizuar. Këtu nuk është fjala vetëm për humbjen e disa temave përemërore dhe për krijimin e disa të tjerave, por për një riorganizim të tillë, që ka shkaktuar transformime të mëdha si në tipet strukturore, ashtu edhe në veçoritë e lakimit të sistemit përemëror të shqipes.

2. Duke qenë se në këtë artikull do të bëhet fjalë për sqarimin historik të veçorivet të lakimit në sistemin përemëror të shqipes, transformimet në tipet strukturore të këtij sistemi do të trajtohen vetëm në ato përmasa, që do të jenë të nevojshme për shtjellimin e temës në shqyrtim, e cila do të synojë të sqarojë:

1) Tiparet arkaike të lakimit tek disa përemra të trashëguar.

2) Ndikimin e lakimit të emrave dhe të mbiemrave mbi atë të disa përemrave.

3) Tiparet e reja të lakimit tek disa përemra të krijuar gjatë zhvillimit historik të shqipes.

I

3. Për sa u takon tiparevet arkaike të lakimit tek disa përemra të trashëguar të gjuhës shqipe, këtu është fjala në radhë të parë për format prej temash supletive tek përemri vetor i vetës së parë njëjës (u-në: *mua*; *me-je*) dhe tek përemrat dëftorë (p.sh. *a-i*, *a-ti-j*, *a-të*, *a-si*, *a-ta*, *a-tc* etj.). Si një tipar arkaik lakimi është edhe alternimi vokalik tek përemrat vetorë të vetës së parë, njëjës e shumës (krahaso *m-ua*: *m-e-je*; *n-a*: *n-e*) dhe të vetës së dytë njëjës (*t-i*: *t-y*, *t-e-je*). Si një tipar arkaik lakimi do të merret edhe alternimi vokalik *-u*: *-ë* si edhe praninë e mbaresës *-sh* tek përemri *kush* (krahaso: *ku-sh*, *ku-jt*, *kë*).

4. Përemri vetor i vetës së parë njëjës edhe në gjuhët e tjera indoevropiane del me dy tema të ndryshme — një për rasën emërore dhe një tjetër për rasat e tjera, si p.sh. në greqishte të vjetër: $\acute{\epsilon}\gamma\acute{\omega}(\nu)$ / $(\acute{\epsilon})\mu\acute{\epsilon}$, $(\acute{\epsilon})\mu\acute{o}\iota$, $\acute{\epsilon}\mu\iota\nu$, $\acute{\epsilon}\mu\epsilon\iota\omicron$, $\mu\omicron\iota$; në latinishte *ego* / *mē* (*d*), *mī*, *mihī* etj.¹

1) Shih për këtë Brugmann, *Grundriss*, II-Band, II-Teil, I-Lieferung, f. 382, v.; Hirt, *Indogermanische Grammatik*, III, 23; H. Krahe, *Einleitung in das vergleichende Sprachstudium* (Innsbruck, 1970), f. 122.

Në përgjithësi është pranuar se edhe përemri dëftor °so, °sā, °tod, me të cilin lidhen dëftorët e shqipes (shih § 28), gjatë lakimit dilte me dy tema supletive — një me s- për emëroren njëjës të gjinisë mashkullore (so) dhe femërore (sā) dhe një me t- për të gjitha rasat e tjera të të tri gjinivet në njëjës dhe në shumës²

Edhe alternimi vokalik si një tipar lakimi ndeshet gjithashtu në gjuhët e tjera indoevropiane tek përemrat vetorë të vetës së parë e të dytë njëjës (shih p.sh. format rasore të lartpërmendura me temë në m- të greqishtes e të latinishtes).

5. Për sa i takon kundërvënies midis emërores u-në dhe rasavet të tjera mua-me-je, është tashmë një gjë e pranuar që u-në nuk është refleksi i indoevropianishtes eg-ō apo eg-om³. Është tashmë e qartë gjithashtu që nga dy variantet e kësaj forme përemërore (u, unë), më i vjetër është varianti u, që ndeshet rregullisht në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë e arbëreshë dhe që haset edhe sot në shumë të folme të Shqipërisë, si në Jug edhe në Veri. Varianti u-në historikisht paraqitet i zgjëruar me një -në⁴, burimi i së cilës mbetet i paqartë. Shtimi i rrokjes -në këtu nuk mund të jetë i hershëm, sepse, përndryshe, në toskërishte -n- midis dy zanoresh do të ish shndërruar në -r-.

6. Mendimi i Meyer-it (EW 454) që përemri vetor u i shqipes e ka burimin tek vetori eo (nga ego) i latinishtes vulgare, është i pambështetur (shih për këtë E. Çabej, «St.fil.» 1, 1967, 65, me literaturë). Lidhur me këtë mendim të Meyer-it do pasur parasysh, ndër të tjera, se një eo latine (me theksin mbi zanoren e parë apo të dytën) në gjuhën shqipe nuk mund të jepte u.

7. Më i mbështetur është mendimi i shprehur nga Jokli (sipas njoftimi që na jep E. Çabej në «St.fil.» 1, 1967, 65) dhe M. La Piana (St. ling. alb. II, 69), që shihnin tek u refleksin e përemrit vetëvetor indoevropian sue-, nga i cili ka dalë edhe pjesëza u e zgjedhimit jovepror⁵. Sipas La Pianës, ky përemër vetëvetor ka qenë përdorur në fillim si përforcues i përemrit vetor të dikurshëm për vetën e parë njëjës, të cilin dalëngadalë e ka zëvendësuar duke e bërë më në fund të dalë fare jashtë përdorimit. Ky shpjegim nuk është i papranueshëm, po të mbahej parasysh se edhe më vonë në gjuhën shqipe është përfutur një dukuri e ngjashme. Është fjala këtu për përemrin ve-të⁶, i cili, siç dihet, përdoret edhe si përforcues i kryefjalës (qoftë kjo një përemër vetor i çfarëdo vete, në njëjës apo në

2) Shih për këtë Brugmann, *vep. cit.*, 313; Hirt, *vep. cit.*, 30 v., Krahe *vep. cit.*, 122.

Por kohët e fundit Louis Heller («Word», vol. 12, Nr. 1, prill 1956, f. 7-8) ka mbrojtur tezën se temat me t- dhe s- të këtij dëftori indoevropian i përkasin së njëjtës rrënjë dhe se s- është përfutur nëpërmjet evolucionit -tt- -ss- -s-. Kështu, sipas tij °so ka dalë nga përsëritja e formës së vjetër të emërores °té; °teté pastaj u reduktua në tté dhe këtu tt- dha ss- e pastaj s-. Po kështu e shpjegon ai edhe formën e femërores °sā.

3) Mendimi i Bopp-it, *über das Albanesische in seinen verwandt-schaftlichen Beziehungen*, 505, i pranuar edhe nga disa gjuhëtarë të tjerë, që u të jetë refleksi i përemrit indoevropian të vetës së parë njëjës (i krahasueshëm me indishten e vjetër *ahām*, etj.), nuk është fonetiksht i mbështetur, prandaj edhe në përgjithësi nuk është pranuar. Shih për këtë edhe E. Çabej, «St. fil.», 1, 1967, 65 v.

4) Një shtesë të tillë e gjejmë nëpër disa të folme edhe tek forma të tjera përemërore si *ti-në*, *ty-në*; *ai-në*, *atë-në* etj., si edhe tek ndajfoljet përemërore *këtu-në*, *aty-në* etj. Në disa të folme gege ndihen format e zgjëruara me rrokjen -na, si *u-na*, *ti-na*, *ati-na*, *asaj-na* etj. Shih për këto edhe M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes* (konspektleksione), f. 25; E. Çabej, «St. fil.», 1, 1967, 66; I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe* (Morfologjia historike) 42

5) Shih për këtë Bopp, *vep. cit.* 480 v. Shih edhe G. Meyer, *Grammatik* 46; Pedersen, *KZ* 36, 290; M. Domi, *vep. cit.* 77; E. Çabej, «St. fil.» 1, 1967, 66 (me literaturë).

6) Shih për këtë fjalë, ndër të tjerë, G. Meyer, *E.W.* 468; Pedersen, *KZ* 36, 290.

shumës, ose një emër), edhe si kryefjalë⁷. Megjithatë, arësyeja e zhdukjes së përmrit vetor të dikurshëm për vetën e parë njëjës mbetet për t'u sqaruar.

8. Format *mua / mue* dhe *me-je*, që për nga tema i kundërvihen asaj të rasës emërore, janë zhvilluar nga tema e vjetër indoevropiane në *m-*, gjurmët e së cilës ndeshen edhe në gjuhët e tjera indoevropiane⁸ (shih edhe § 4). Së njëjtës temë i përket edhe pronori *mi* (sot *e mi*), që, siç do të shtjellohet më poshtë (§§ 14-15), në zanafillë duhet të ketë qenë gjindorja e përmrit vetor të vetës së parë njëjës.

9. Forma *mua*, geg. *mue* (tek Buzuku e Budi *muo*), siç e kanë sqaruar Meyer-i (Alb. St. III, 86) dhe Jokli (IF 49, 274), ka dalë nga një formë më e vjetër ^o*mō-n* (e kjo ndofta nga një më e vjetër ^o*mēm*⁹), ku *ō-*ja në rrokje të mbyllur nga *-n* me kohë është zbërthyer në një tog zanoresh ashtu si tek *ftua / ftue*, *krua / krue* etj.¹⁰ Forma *mua / mue*, e cila, siç dihet, shërben si për rasën kallëzore ashtu edhe për dhanoren, në zanafillë duhet të ketë qenë formë e një rase të vetme. Lidhur me këtë, do pasur parasysh që *-n* tek ^o*mō-n* ka qenë mbaresa e njohur e kallëzores njëjës, e cila tek kjo formë përemërore mund edhe të jetë shtrirë që në kohë shumë të lashta për analogji nga kallëzorja njëjës e emravet mashkullorë e femërorë¹¹. Fundorja *-n*, nga ana e saj, do të ketë shkaktuar edhe gjatësinë e zanores paraprise (*-ō-*), duke krijuar kështu kushtet për diftongimin e saj. Zanorja *-o-* tek ^o*mo-* nuk mund të jetë refleksi i një *-o-*je indoevropiane, të gjatë apo të shkurtër, sepse, siç dihet, *ō-*ja dhe *o-*ja indoevropiane në gjuhën shqipe janë reflektuar me *e*, përkatësisht *a* (shih për këtë Meyer, Alb. St. III, 87-88; Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, 95, 96). Në të tilla rrethana duhet pranuar që *mo-* e shqipes është refleksi i një ^o*mē-*, që dëshmohet si formë e kallëzores edhe për gjuhë të tjera si latinishtja, irishtja etj. (shih Brugmann, vep. cit. 383; Hirt, vep. cit. 23; Krahe, vep. cit. 123).

Përdorimi i formës së kallëzores *mua / mue* edhe në funksionin e dhanores duhet të ketë zënë fill, pasi forma e gjindores *mi* (shih §§ 14-15) kishte kaluar në klasën e pronorëvet.

10. Për sa i takon trajtës së patheksuar *më*, e cila, ashtu si e theksuara *mua / mue*, përdoret si për kallëzoren edhe për dhanoren, ajo ka dalë nga forma e plotë përgjegjëse në pozicion jashtë theksit. Me fjalë të tjera *-ë* tek *më* ka dalë nga reduktimi i zanores (a i dy zanorevet) të formës së plotë, që sot del *mua / mue*. Sidoqoftë, kjo trajtë e reduktuar, që paraqitet kështu edhe tek autorët më të vjetër shqiptarë dhe që është e përbashkët për të gjitha të folmet e shqipes, dëshmon për një moshë relativisht të vjetër të saj¹².

7) Shih për këtë M. Domi, vep. cit. 25; Sh. Demiraj, Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe (dispensë), II, 117 v.

8) Për këtë temë përemërore në gjuhët indoevropiane shih Brugmann, vep. cit. 383; Hirt, vep. cit. 23; Krahe, vep. cit. 122.

9) Meyer-i e pat krahasuar këtë formë përemërore të shqipes me avestishten dhe persishten e vjetër *mām*, sllavishten e vjetër *mē* dhe prusishten e vjetër *mien*.

10) Për kushtet fonetike dhe fazat e ndryshme të evolucionit të këtij togu zanoresh shih Meyer, Grammatik, 5; Jokl, IF 49, 276 v; E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe dhe Fonetika historike e shqipes (dispensë), 104 v.

11) Për mbaresën *-n* të kallëzores tek emrat shih, ndër të tjerë, M. Domi, vep. cit. 13; Sh. Demiraj, «St. fil.» 2, 1973, § 29.

12) Nuk po ndalem këtu në pyetjet se *kur* dhe *si* janë përfutur trajta e patheksuar *më* dhe trajtat e tjera të patheksuara të përmravet vetorë. Këto çështje janë trajtuar në një punim tjetër ende të pabotuar, ku janë bërë përpjekje për të sqaruar edhe gjenezën e formave të patheksuara të vetës së tretë njëjës (*e*, *i*) dhe shumës (*u*, *i*).

11. Për sa i takon formës *me-je*, do pasur parasysh se mbaresa rasore *-je* është një shtesë analogjike relativisht e vonë (shih § 52).

Për Meyer-in (Alb. St. III, 89) *me-* është refleksi i indoevropianishtes $^{\circ}moi$, e krahasueshme me greqishten e vjetër dhe me indishten e vjetër *mē*. Meyer e sjell këtë formë, ashtu si *te-je* (shih § 23), si një dëshmi në të mirë të tezës së tij që diftongu indoevropian *oi* nëpërmjet *ai* në gjuhën shqipe ka dhënë *e*. Këtë tezë e kundërshtoi Pedersen (KZ 36,315), sipas të cilit *oi* në fund fjale në gjuhën shqipe është reflektuar me *-a*, ndryshe nga një *-oi-* në trup fjale që ka dhënë *-e-*. Kurse për E. Çabejnë («St.fil.» 2, 1970, 81) diftongu *-oi-* edhe në trup fjale në gjuhën shqipe është reflektuar me *-a-*. Sipas këtij gjuhëtari *-e* tek *me-* (ashtu si edhe tek *te-je*) nuk është refleksi i diftongut *-oi*.

Unë bashkohem me mendimin që *me-* (ashtu si *te-* tek *te-je*) nuk është refleksi i formës së rindërtuar $^{\circ}moi$ (përkatësisht $^{\circ}toi$). Por mendimi tjetër i E. Çabejt që diftongu *-oi* edhe në fund fjale është reflektuar me *-a* nuk më del i argumentuar bindshëm¹³.

12. Sipas M. Domit (vep. cit. 25) dhe I. Ajetit (vep. cit. 42), *mē* është refleksi i një forme më të vjetër $^{\circ}mō-$. Fonetikisht ky shpjegim është i përligjur. Por këta autorë nuk japin ndonjë sqarim mbi përkatësinë rasore të formës së rindërtuar $^{\circ}mō-$. Një formë e tillë e rindërtuar nuk dëshmohet si rrjedhore (dhe as si ndonjë rasë tjetër) në asnjërën nga gjuhët e njohura indoevropiane (shih Brugmann, vep. cit. 426; Hirt, vep. cit. 23).

13. Ka më shumë të ngjarë që *me-* e shqipes ta ketë burimin tek forma $^{\circ}me$ ¹⁴ e indoevropianishtes, e cila, me sa duket, ka shërbyer si pikënisje për formimin e të gjitha formave rasore me temë në *m-* (shih § 9, si edhe § 15). Refleksi i një *e-je* të shkurtër indoevropiane me *e* në gjuhën shqipe nuk është i pamundshëm (shih për këtë Meyer, Alb. St. III, 85 v.; Çabej, vep. cit. 94).

14. Siç u vu në dukje edhe në § 8, temës përemërore në *m-* i përket edhe pronori *mi* (sot *e mi*), që shërben si formë shumësi e pronorit të vetës së parë njëjës *im* (krahaso: djali *im* — djemtë *e mi*). Tashmë është një gjë e vërtetuar se forma përemërore *e mi* në një kohë më të vjetër nuk e ka pasur nyjen e përparme, pra dilte *mi*, formë kjo që është edhe e dokumentuar (shih sidomos E. Çabej, «St. fil.» 3, 1963, 78). Tek forma përemërore *mi* mbetet për të sqaruar sidomos zanafilla e fundores *-i*. Sa për nistoren *m-*, kjo lidhet pandërmjetshëm me temën e përemrit vetor në *m-* (shih § 8 si edhe § 67).

Dh. Kamarda (Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese, 219) dhe S. Riza (BUSHT, SShSh 3, 1959, 6-7) kanë parë tek fundorja e theksuar *-i* e formës *mi* mbaresën e shumësit *-i*¹⁵. Ky shpjegim nuk është për t'u përjashtuar patjetër, por ka shumë pak gjasë që shumësi i pronorit *im* të jetë formuar krejt ndryshe nga ai i pronorëvet të tjerë (krahaso p.sh. *y-në*: *ta-në*; *jo-në* *to-n-a*; *y-j*: *ta-j*, etj.). Gjithashtu mbetet për t'u argumentuar edhe zhdukja e nistores *i-* të formës së pretenduar $^{\circ}im-i$ të pronorit shumës, që rindërton S. Riza (në vendin e cituar) si edhe shpërngulja e theksit mbi «mbaresën e shumësit», gjë që nuk ndodh në format e shumësit të pronorëvet të tjerë. Prandaj nuk del bindës po-

13) Për formën *a-ta* të dëftorit mashkullor shumës, që E. Çabej e sjell si një nga dëshmitë në të mirë të tezës së tij, shih §§ 43-44.

14) Sipas Brugmann-it, vep. cit. 383, temat e përemrit vetor të vetës së parë njëjës, prej të cilave kanë dalë format rasore (me përjashtim të emërores) në gjuhët e ndryshme indoevropiane, kanë qenë *me*, *mo-*.

15) Për këtë mbaresë shumësi shih edhe Pedersen, *Albanesisch* 1905, në Rom. Jb. IX, I, 209; si edhe vërejtjet e mia në *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, 112 v.

himi i tij se «ka qenë pikërisht toniciteti i kësaj mbarese shumësi që në shumësin ^o*imii* ka sjellë njëherë atonizimin e zanores iniziale *i-* e pastaj edhe zhdukjen e saj, siç ndodh p.sh. duke kaluar nga njëjësi «(i) *keq*» në shumësin «(të)këqij», i cili gegërisht shqiptohet edhe «(t)kqij».

Lidhur me këtë pohim të S. Rizës do pasur parasysh edhe se rënia e *-ë-së* së patheksuar tek shumësi «(të)këqij» (më saktë *të këqi*) në gegërishte është relativisht e vonë; tek autorët e vjetër veriorë ajo ruhet. Kurse gjurmë të një *ë-je* të patheksuar para *mi* nuk ndeshen gjëkund.

15. Ka më shumë të ngjarë që forma e pronorit *mi*, ashtu si forma e pronorit *tu* (shih për këtë § 22), ta ketë burimin tek forma e dikurshme e gjindore-dhanores së përemrit vetor të vetës së parë njëjës, që është përdorur motit edhe si pronor dhe që me kalimin e kohës ka mbetur në përdorim vetëm si pronor. Një dukuri e tillë që është e njohur për gjuhët indoevropiane¹⁶, gjen mbështetje edhe në faktin që në kohë relativisht më të vona (pasi ishte shfaqur në shqipe «nyja e përparme» e gjindores) kanë kaluar në klasën e pronorëve edhe format *i(e, të) tij, i(e, të) saj, i(e, të) tyre*, që për nga burimi s'janë gjë tjetër veçse gjindore të adjektivuara të përemrave vetorë të vetës së tretë njëjës, përkatësisht shumësi.

Si rrjedhim, unë jam i prirur të shoh tek forma *mi* ose refleksin shqiptar të formës indoevropiane ^o*moi* (^o*mei*) që, sipas Brugmann-it, vep. cit. 309 (shih edhe Hirt, vep. cit. 22), ka shërbyer «që nga koha e lashtë indoevropiane si gjindore e dhanore», ose refleksin e një forme të dhanores ^o*me-i*, të ndërtuar duke i shtuar formës së vjetër përemërore *me-* mbaresën e dhanores *-i* të emrave (shih për këtë vërejtjet e mia në «St.fil.» 2,1973, §§ 30-32).

16. Siç u vu në dukje edhe në § 3, alternimi vokalik si një tipar arkaik lakimi ndeshet edhe tek përemri vetor i vetës së parë shumësi si edhe tek ai i vetës së dytë njëjës.

Për sa i takon alternimit *-a: e* (*n-a, n-e*) tek përemri vetor i vetës së parë shumësi, shpjegimi i Meyer-it (Alb. St. III, 87-88, EW 296) që *na* është refleksi i emërores ^o*nō-s*, dhe *ne* refleksi i kallëzores ^o*nō-s*, është fonetiki i mbështetur. Ky shpjegim, që është miratuar edhe nga Brugmann-i, vep. cit. 408, Domi vep. cit. 26 dhe Ajeti, vep. cit. 43, është në përputhje të plotë me të dhënat e fonetikës historike të shqipes, sipas të cilës *o* dhe *ō* (të theksuara) indoevropiane kanë dhënë në gjuhën shqipe *a*, përkatësisht *e*. Por në këtë rast mbetet për të sqaruar arësyeja e ndryshimit të kuantitetit të zanores *-o-* në rasat emërore (*nōs*) dhe kallëzore (*nōs*), si edhe gjatësia e zanores tek forma *nē*, ashtu siç na del kjo në shkrimet e autorëve të vjetër. Në këto rrethana, mendimi i Joklit (IJ XII, 150) që *nē* ka dalë nga *na+e* (kjo e fundit mbarese e vjetër e gjindores shumësi), nëpërmjet kontraksionit *a + e = e*, nuk është i pambështetur fonetiki¹⁷. Në këtë rast

16) Pronorët në gjuhët indoevropiane kanë qenë «në lidhje të ngushtë» me gjindoren e përemrave vetorë. Në mjaft raste ata janë zhvilluar nga format e gjindores së vetorëve, por, nga ana tjetër, ka edhe raste që gjindorja e vetorëve e ka burimin tek forma pronorësh, si p.sh. në latinishte gjindoret *mei, tui, sui* etj. (shih Brugmann, vep. cit. 403).

17) Ndryshe mendon për burimin e formës *ne* La Piana, *Intorno al riflesso dell' «o» lunga dall' Indoeuropeo e dal Latino nell'Albanese*, 14. Sipas tij, forma *ne* është përfutur nga një formë më e vjetër e dhanores *na-ve*, e cila nëpërmjet një asimilimi regresiv ka dhënë *neve* dhe kjo nëpërmjet një kontraksioni ka dhënë *nee > nē > ne*. Ky shpjegim i La Piana, që e përmend edhe M. Domi vep. cit. 26, si edhe I. Ajeti, vep. cit. 43, më duket i pambështetur. Si rregull, është zanorja e theksuar ajo që asimilon të theksuarën dhe jo anasjelltas. Veç kësaj, autori nuk sqaron përse këtu ka rënë *-v-*ja e mbaresës *-ve*, që e ka burimin tek lakimi i emrave, siç e ka pranuar edhe ai vetë (po aty).

duhet pranuar që forma e gjindore-dhanores me kohë është shtrirë edhe në kallëzore. Pra, çështja e burimit të formës *ne* mbetet e hapur.

Forma *ne* ka shërbyer si bazë edhe për formimin e dhanores *ne-ve* dhe të rrjedhores *ne-sh*, me shtimin analogjik të mbaresavet rasore *-ve* dhe *-sh* të sistemit emëror (shih edhe § 53).

17. Për sa i takon formës së patheksuar *na*, që përdoret si në dhanore edhe në kallëzore, ajo në këtë përdorim nuk duhet të jetë shumë e vjetër. Përndryshe, zanorja *-a*, duke u ndodhur jashtë theksit, duhej të ish reduktuar në *-ë*, ashtu siç ka ndodhur në dy vetat e para të njëjësit (*më, të*). Me sa duket, kjo formë e ka burimin tek forma e rasës emërore (*na*) të cilën gjuha do ta ketë shfrytëzuar edhe në këtë funksion të dytë, për të krijuar kështu një kundërvënie të plotë me vetën e parë njëjës, ku krahas formës së theksuar ishte në përdorim edhe e patheksuara¹⁸.

18. Edhe tek vetori i vetës së dytë njëjës (*ti, ty, te-je*) diferencimi formal midis rasavet të ndryshme bëhet kryesisht nëpërmjet alternimit vokalik *-i: y: -e*; mbaresa *-je* tek *te-je*, ku është shtuar për analogji nga sistemi emëror (shih § 52), është hiperkarakterizuese. Me përemrin *ti* do lidhur edhe pronori *tū* (sot *e tu*), që, siç do të shtjellohet më poshtë (§ 22), në zanafillë duhet të ketë qenë forma e rasës gjindore të vetorit.

Sqarimi historik i formavet rasore të këtij përemri paraqitet shumë i vështirë.

19. Për formën e rasës emërore më duket më i mbështetur fonetikisht shpjegimi i Meyer-it (Alb. St. III, 23 e 81; EW 430), sipas të cilit *ti* është refleksi i përemrit indoevropian *tū* nëpërmjet *tj̄*. Evolucionin fonetik *ū: j̄: i* më duket më i natyrshëm se evolucionin *ū: i* që presupozon për këtë rast Pedersenin (KZ 36, 282) dhe që e miraton edhe Çabej («St. fil.» 2, 1966, 73 v.)

Por, kur trajton alternimin *-u / -i* të nyjes së prapme për rasën emërore njëjës të gjinisë mashkullore, Pedersenin *implicite* pranon si fazë të ndërmjetme evolucionin *u: y* (khs. bujk-*u, a-y / a-i*).

20. Për sa i takon formës së kallëzores (e të dhanores) *tj̄* (sot *ty*), bashkohem me vërejtjen kritike të E. Çabejt («St. fil.» 2, 1966, 74) kundër Pedersenit (KZ 36, 282), që e bie të ardhur nga një formë e rindërtuar ^o*tve*, ku fundorja *-e* «nën ndikimin e *-v*-së paraprise» paska evoluar në *-y*. Bashkohem gjithashtu me mendimin e E. Çabejt (po aty) që *tj̄* të ketë dalë nga një *tū*, por nuk më duket e nevojshme që *u*-ja të ketë qenë «jo fundore, po në trup fjale», siç shton ai¹⁹.

18) Një gjë e ngjashme ka ndodhur edhe në vetën e dytë shumës, ku forma e patheksuar *u* (sot *ju*) e ka burimin gjithashtu tek forma e theksuar e dikurshme *u* (sot *ju*). Shih për formën *j-u* Pedersen, *Festschrift*, 252 v.; E. Çabej, «St. fil.» 1, 1967, 67; M. Domi, *vep. cit.* 26; I. Ajeti, *vep. cit.* 44.

19) Ja si shkruan ai: «Thjesht fonetikisht mund të mendohet që *tj̄* të ketë dalë nga një *tū* me *u* të gjatë jo fundore, po në trup fjale. Kjo do të paravendonte praninë dikur të një silabe të dytë pas *u*-së, pajisur në ballë të saj me një okluziv të zëshëm, i cili në pozicion intervokalik u zhdruk, bashkë me vokalin fundor. Khs. prej greq. së vjetër forma të tilla si *ἐγωγε*, *ἐμεγε* për *ἐγώ* «unë», *ἐμέ* «mua», *σύγε* për *σύ* «ti», dor. *τύγα* për *τύ*, leot *τουγα* etj. te Schwyzeri Gr. Gr. I, 606, ose het. *zik* e *ziqqa* «ti» nga një ^o*tega* te Friedrich, *Hethit. Wörterbuch* 260.»

Pra, ka më shumë të ngjarë që *t̄y* e kallëzore-dhanores, ashtu si *ti* e rasës emërore, ta ketë burimin tek një *t̄ā*. Ruajtja e timbrit të *ȳ*-së tek *t̄y*, me sa duket, është diktuar nga nevoja për të shprehur kundërvënien formale me rasën emërore *ti*. Edhe bjerrja e gjatësisë, «që mund të ketë pasur më parë» zanorja *-i* (tek *t̄i*) mund të jetë diktuar nga nevoja «për ta bërë këtë opozicion më të dukshëm», ashtu siç mendon E. Çabej (në vendin e cituar).

21. Edhe forma e patheksuar e vetës së dytë njëjës *tē*, e cila ashtu si *mē* dhe *na* (shuh §§ 10, 17) përdoret si për rasën dhanore ashtu edhe për kallëzoren, ka dalë nga reduktimi i formës së plotë (që sot kumbon *ty*) në pozicion jashtë theksit.

22. Forma përemërore *t̄ū²⁰* (sot *e tu*), që shërben si formë shumësi e pronorit të vetës së dytë njëjës (krahaso: djali *yt* — djemtë *e tu*), do të ketë qenë, ashtu si *mī* (§ 15), gjindorja e vetorit të vetës së dytë njëjës, që është përdorur motit edhe si pronor dhe që me kalimin e kohës ka mbetur në përdorim vetëm si pronor.

Një mendim të ngjashëm e ka shprehur më parë Bopp-i, vep. cit. 521, i cili pohon: «Kështu *u-t* [= *y-t* — Sh.D.] fjalë për fjalë do të thotë *ó σοῦ*, ku përemri i vetës së dytë në raport gjindoreje përfaqësohet vetëm nëpërmjet *-t*, kurse në shumësin mashkullor *e tu* «deine» (fjalë për fjalë *oi σοῦ* Marc. III. 32), *tu* i përgjigjet [korespondon] formës së paraqitur nga Xylander-i si gjindore e përemrit vetor të vetës, së dytë *tu* (*σοῦ*), (për të cilën Hahn i ka *τυγ* (me *vy* si mbaresë rasore), Lecce-ja *ty*».

Edhe për Kamardën (vep. cit. 220) «Shumësi i pronorit të vetës së dytë ruan më shumë prej origjinalit, sepse bën *t̄ū* (tek Hahn-i *e tu*, me një *e* përemërore të parashtruar, ndofta si *nyje*. . .)».

Për sa i takon mendimit të S. Rizës (BUSHT, SShSh 3, 1959, 7) që «shumësi (të) *tu* i njëjësit *yt* nuk është sekundar por primar», do vërejtur se ky pohim është i drejtë vetëm për trupin e përemrit pa nyjen e përparme. Kjo e fundit këtu është relativisht e vonë, prandaj edhe nuk është aglutinuar me trupin e pronorit. Si rrjedhim, mendimi i S. Rizës (po aty) që tek kjo formë shumësi *nyja* nuk është aglutinuar me trupin e pronorit, sepse ky nuk pat pësuar reduktim fonetik, nuk është i mbështetur; për më tepër, ai nuk sqaron as arësyen e mungesës së një reduktimi të tillë fonetik.

Në të tilla rrethana, mund të supozohet që forma *t̄ā*, e cila në zanafillë i ka takuar rasës emërore, me kohë është shtrirë edhe në rasat kallëzore, dhanore e gjindore. Një dukuri e tillë nuk është e pamundur, po të mbahet parasysh se edhe tek vetori i vetës së dytë shumës forma *ju* (nga *u*; me një *j*-nistore të shtuar) përdoret prej kohësh si formë e përbashkët e emërores dhe e kallëzores dhe ka shërbyer si bazë edhe për format e dhanores *ju-ve* e të rrjedhores *ju-sh* (shih për këto § 53).

Tek pronori *tu* mbetet për t'u sqaruar mungesa e evolucionit *ū:ȳ* (si tek forma e vetorit *t̄y*). Ka të ngjarë që në përdorimin e saj si pronor kjo formë përemërore të mos e ketë ruajtur të plotë gjatësinë e zanores *u*, për shkak të theksimit relativisht më të dobët të pronorëvet (në krahasim me vetorët korespondues), sidomos në pozicion para emrit.

Supozimi i Kamardës (vep. cit. 220) që *ū*-tek pronori *t̄ū* të ketë dalë nga kontraksioni *-ui* ose *-ue* është i pambështetur fonetiki. Për më tepër ai nuk sqaron se ç'kanë përfaqësuar historikisht *-ui* ose *-ue*

20) Për ekzistencën e kësaj forme arkaike pronori pa «nyje të përparme» shih edhe E. Çabej BUSHT, SShSh 3, 1963, 78, 86.

23. Për formën *te* (sot *te-je*), që Meyer-i (Alb. St. III, 89) e shpjegon si refleksin e indoevropianishtes ^o*toi* dhe e krahason me greqishten e vjetër *τοί* dhe me indishten e vjetër *tē*, (d.m.th. jep të njëjtin shpjegim si për *me-*), vlejné po ato vërejtje që u dhanë për *me-* < *moi* (shih § 11).

Por në EW 430 Meyer-i pohon se *te-* është refleksi i një forme më të vjetër ^o*teu-*, të krahasueshme me greqishten *τεῦς*. Ky shpjegim, që përmendet edhe tek M. Domi (vep. cit. 26), E. Çabej («St. fil.» 2, 1966, 74) dhe I. Ajeti (vep. cit. 43), fonetikisht nuk është i papranueshëm. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që forma *te-* ta ketë burimin tek indoevropianishtja *te-*, që jep Brugmann-i (vep. cit. 383) si formë bazë të këtij përemri krahas formës së zgjëruar ^o*teue*, ^o*tue* (shih edhe vërejtjet për *me-je* tek § 13).

24. Siç u vu në dukje edhe në § 3, tipare arkaike lakimi ndeshen edhe tek përemri dëftor (*a-i* / *a-y* dhe *k-y*), ku format rasore dallohen midis tyre kryesisht nëpërmjet alternimeve konsonantike dhe vokalike. Këtu nuk është fjala për kundërvënien midis parashtesavet *a-* dhe *k(ē)-*, nëpërmjet të cilavet dëftori i dikurshëm i shqipes është bigëzuar në dy përemra paralele, që, siç dihet, përdoren për të treguar sende latg, përkatësisht afër folësit. Këto parashtesa i takojné një periudhe relativisht të vonë të shqipes, prandaj nuk vijnë në vështrim këtu. Shih për këto parashtesa, ndër të tjerë, Pedersen, Les pronoms démonstratifs de l'ancien arménien (në Det Kongelige Danske Videnskabernes Selskabs Skrifter — Sjette Bind — 1907), f. 315 [=13]; Xhuvani-Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe, BShSh 4, 1956, 68, 72; M. Domi, vep. cit. 28; I. Ajeti, vep. cit. 45 v.

25. Sqarimi historik i paradigmës së ndërlikuar të dëftorit të shqipes paraqit vështirësi të shumta të karakterit morfologjik dhe fonetik. Me gjithë përpjekjet e bëra për kapërcimin e këtyre vështirësive, mjaft gjëra mbeten ende të pasqaruara bindshëm. Pyetja themelore, që mbetet për t'u sqaruar, është kjo: A është e tërë paradigma e dëftorit të shqipes vazhdimi i paradigmës së një dëftori të vetëm indoevropian, apo është rezultati i përzierjes së temavet të ndryshme përemërore? Kësaj pyetjeje i janë dhënë dy përgjigje të ndryshme.

26. G. Meyer-i (Alb. St. III. 79, 40; EW 5) ka qenë i mendimit se format e ndryshme rasore të dëftorit të shqipes e kanë burimin tek tema të ndryshme përemërore. Kështu, sipas tij, (*a-*)*i*, (*a-*)*jo* e kanë zanafillën tek tema përemërore indoevropiane ^o*is*, ^o*iā*; format me *t-* (*a-tē*, *a-ti*, *a-ta*, *a-to*, *a-tyre*) ai i lidhte me temën përemërore indoevropiane *to-*, kurse format me *s-* (*a-si*, *a-sa-j*, *a-so*, *a-sish*, *a-sosh*) ai i lidhte me temën përemërore indoevropiane *k̄i*²¹ (me *k̄-* palatale). Për sa i takon alternimit *-i*: *-y* (*a-i*: *a-y*, *k-y*), Meyer-i mendonte se forma me *-i* ka qenë primare dhe se ajo është kthyer në *-y* në fillim tek përemri *ky* (nga ^o*kē* + *i*) nën ndikimin e bashkëtingëllores *k-*; tek *a-y* alternimi *-i*: *-y*, sipas tij, është bërë nën ndikimin analogjik të *ky*.

27. Kundër shpjegimit të Meyer-it Pederseni (Festschrift til Vilhelm Thomsen, 251 v.; KZ 36, 311 v.) ka parashtruar një varg vërejtjesh kritike, nga të cilat po përmendim: Forma me *-i* (*a-i*) mund të sqarohet me anë të dëftorit indoevropian ^o*is*, por forma me *-y* (*a-y*) vështirë se mund të ketë dalë nga ^o*kē* + *i*; veç kësaj duhet sqaruar kjo *y* edhe tek pronorët *y-t*, *y-në*. Është e pamundur që *-jo* tek *a-jo* ta ketë burimin tek forma femërore e dëftorit indoevropian ^o*iā*, sepse një *i*

21) Edhe La Piana, *St. ling. alb.* II, 71, paradigmën e dëftorit të shqipes e lidhte me tri tema përemërore indoevropiane.

a *j*-indoevropiane në gjuhën shqipe ka dhënë *gj*²². Pedersenin vë në dukje gjithashtu se *s*- (tek *a-si*, *a-sa-j*, *a-so* etj.) nuk mund të jetë refleksi i *k̄*-, sepse *k̄*-ja palatale indoevropiane në gjuhën shqipe është reflektuar me *th*. (Shih për këtë E. Çabej, Hyrje në hist. e gjuhës shqipe, 109, si edhe «St. fil.» 2, 1970, 82).

28. Për Pedersenin (KZ 36, 312) e gjithë paradigma e dëftorit të shqipes e ka burimin tek tema përemërore indoevropiane më *to*-. Është fjala për përemrin dëftor indoevropian ^o*so*, ^o*sā*, ^o*tođ* (shih § 4), gjurmë të të cilit ndeshen edhe në gjuhë të tjera si në greqishten e vjetër dhe në të renë (*ho*, *hē*, *to*), në indishten e vjetër, në armenishte, lituanishte, latinishte, gotishte, në bullgarishte të vjetër dhe irishte (shih Brugmann, vep. cit. 313; Hirt. vep. cit. 30 v.).

29. Siç do të shtjellohet edhe në paragrafët ndjekës, teoria e Pedersenit mbi burimin e përbashkët të të gjitha formave rasore të dëftorit të përbashkët (për të tri gjinitë dhe për të dy numrat) në përgjithësi paraqitet mjaft e mbështetur. Por duhet pranuar se në disa pika të veçanta — për format e rasës emërore të gjinisë mashkullore, njëjës e shumës (*a-y* / *a-i*, *a-ta*), për format rasore me *s*- (*a-si*, *a-sa-j* etj.), si edhe për formën e gjindore-dhanores shumës (*a-tyne* / *a-tyre*) — sqarimet e Pedersenit lënë shteg për mjaft vërejtje kritike (shih §§ 36-46).

30. Plotësisht i mbështetur nga të dhënat e fonetikës dhe të morfologjisë historike të shqipes paraqitet sqarimi i formave rasore *a-jo*, *a-ta* (emërore dhe kallëzore njëjës e gjinës asnjëse, *a-të* (dikur *a-ta* — kallëzore njëjës e gjinivet mashkullore e femërore), *a-ti(j)* dhe *a-to* (emërore e kallëzore shumës e gjinivet femërore dhe asnjëse).

31. Për formën e rasës emërore njëjës të gjinisë femërore *a-jo* (kë-*jo*) mund të pranohet pa rezerva shpjegimi i Pedersenit (Festschrift, 252; KZ 36, 313v.), sipas të cilit *-j*- historikisht është një tingull i shtuar kundër hiatit midis parashtesës *a-* (kë-) dhe formës përemërore të dikurshme *-o*; kjo e fundit është refleksi i formës indoevropiane ^o*sā*, nëpërmjet evolucionit ^o*sā* > ^o*hā* > *o*.

32. Edhe në formën e gjinisë asnjëse njëjës *-ta* (*a-ta*, kë-*ta*) del fonetikisht dhe morfologjikisht i mbështetur shpjegimi i Pedersenit (KZ 34, 284, 288; 36, 314), i cili e lidhte këtë me formën asnjëse indoevropiane ^o*tođ* (nëpërmjet evolucionit të njohur *o* > *a* të shqipes dhe rënies së fundores *-đ*).

33. I mbështetur fonetikisht dhe morfologjikisht paraqitet edhe shpjegimi i formës së kallëzores njëjës të gjinivet mashkullore e femërore (*a-*) *të* (dikur (*a-*)*ta*, që Pedersenin (KZ 36, 314) e bie të ardhur nga format më të vjetra ^o*tom* (> ^o*tam*) të gjinisë mashkullore dhe ^o*tām* të gjinisë femërore.

Forma (*a-*)*të* e toskërishtes është një dëshmi e qartë se kjo dikur dilte me *-a* hundore (*a-*) *ta-*, ku timbri hundor është shkaktuar nga bashkëtingëllorja hundore ndjekëse *-n*²³ (shih për këtë edhe Jokl, IF 36, 102). Për formën më të vjetër *-tan* të kallëzores dëshmon edhe forma e kallëzores së përemrit pronor *tan-d*. (shih për këtë Pedersen, KZ 36, 314). Kurse formën e kallëzores me *-a* hundore, na e dëshmon Bogdani (...tue pam se gjithë profetisë mbë *tan*' po mbusheshinë... «vedendo che tutte le cose legali e profetie dei profeti erano in *lui* compite...»). E kanë për t'u bekuem ndë *tan* gjithë pjesëtë dheut. «et benedicende in illo omnes nationes terrae» — pj. I e veprës, II/III/9; II/IV/2).

22) Pranuar në përgjithësi edhe nga E. Çabej «St. fil.» 2, 1970, 93. G. Meyer-i, *Alb. St.* III, 40, pohon se *j*- gjysëmvokalike në gjuhën shqipe ka dhënë *j*- e *jo gj*- si *j*-ja spirante. Por shembujt e sjellë prej tij nuk e mbështesin këtë pohim. Shih edhe kritikën e E. Çabejt në «St. fil.» 2, 1970, 93.

23) A ka qenë kjo mbaresë e kallëzores në zanafillë *-n* apo kjo e fundit është rezultati i evolucionit të *-m*, mbetet një çështje e hapur, me të cilën shpresoj të merrem në një rast tjetër.

34. Edhe forma *a-ti(j)* e gjëndore-dhanores njëjës të gjinivet mashkullore dhe asnjane është plotësisht e shpjgueshme në bazë të teorisë së Pedersenit, i cili (KZ 36,315), formën *-ti* e nxjerr nga një $^{\circ}tei$, që në zanafillë duhet të ketë qenë formë e dhanores, ku *-ei*, ka dhënë *-i*, ashtu si tek emrat (shih edhe «St. fil.» 2, 1973, § 31). Ky shpjegim është për t'u parapëlqyer ndaj atij të M. Domit (vep. cit. 29) dhe të I. Ajetit (cep. cit. 47), që shihnin tek *ti(j)* një formë me origjinë lokativi.

35. I mbështetur fonetikisht dhe morfologjikisht është edhe shpjegimi i formavet homonime të emërores e të kallëzores shumë për gjinitë femërore e asnjane (*a-to*). Sipas Pedersenit (KZ 36,315), shumësi femëror (*a-to*) është refleksi i $^{\circ}tās$, kurse shumësi asnjane (*a-to*) është refleksi i $^{\circ}tā$ (nëpërmjet evolucionit të njohur $\bar{a} > o$ të shqipes).

36. Një nga format rasore të dëftorit të shqipes, që mbetet e pasqaruar bindshëm nga Pedersenit, siç u vu në dukje edhe në § 29, është ajo e rasës emërore njëjës të gjinisë mashkullore, që del me variantet *-y* dhe *-i* (*a-y / a-i, k-y*). Pedersenit (Festschrift, 251 v.; KZ 36, 313), në kundërshtim me Meyer-in (shih § 26), mendonte se *-y* është historikisht primare ndaj *-i*. Sipas tij, *-y* e ka burimin tek forma indoevropiane $^{\circ}so$; e cila pas evolucionit *s-h-24* dha $^{\circ}ho$; pastaj *h-* ka rënë, ashtu si edhe në raste të tjera. Ai shton se *-o* u shndërrua në *-u* e që këtej ka dalë *y-ja* e dëftorit, e cila ka evoluar më tej në *-i* (*a-y / a-i*).

37. Lidhur me këtë shpjegim të Pedersenit do shënuar se evolucionet $-o > -u$ dhe $u > y$ kanë mbetur të pasqyruar bindshëm. Vështirësinë e rastit të parë ($-o > -u$) e ka ndjerë edhe vetë autori, i cili në Festschrift, 252, megjithëse pranon që *o-ja* «në pozicion mesor» jep *a*, shton se nuk ka asgjë të pamundshme të mos pranohet «një proces i ndryshëm për pozicionin fundor». Kurse për evolucionin $u > y$ ai për këtë rast nuk ka dhënë gjëkund ndonjë sqarim.

Për sa i takon supozimit që *o-ja* të jetë alternuar në *u* vetëm për shkak të pozicionit të saj fundor, Pedersenit nuk e ka argumentuar atë më tej, prandaj një supozim i tillë mbetet i pambështetur. Megjithatë, supozimi në vetëvetë nuk duhet hedhur poshtë patjetër. Nuk duhet përjashtuar mundësia që në këtë rast alternimi $o > u$ të jetë shkaktuar nga një velarizim i mëtejshëm i zanores *-o* nën ndikimin e grykores paraprise *h-* (pra $^{\circ}ho > ^{\circ}hu$).

Edhe alternimi *u: y* në këtë rast nuk është i pamundshëm, në rast se pranohet që *u-ja* tek dëftori i dikurshëm $^{\circ}u$ (*a hu*), për shkak të një theksimi të fuqishëm, mund të jetë shqiptuar e gjatë. Në përgjithësi dëftorët, në përdorim për-emëror, ashtu si edhe pyetësit, janë shqiptuar më fuqishëm se përemrat e tjerë (shih Brugmann, Grundriss, I, 952; II/II, 312, 313; shih edhe Jokl, IF 36; 99).

Sidoqoftë, çështja e formës së rasës emërore njëjës të dëftorit mashkullor mbetet ende e pasqyruar në mënyrë plotësisht të argumentuar.

38. Jo më pak të kritikueshme janë edhe sqarimet e dhëna nga Pedersenit për format rasore të dëftorit të shqipes, që nisin me *s-*. Për formën *a-si* (rrjedhore njëjës e gjinivet mashkullore dhe asnjane) Pedersenit (Festschrift, 251, KZ 36, 314) mendon se mund të jetë refleksi i $^{\circ}tojéi$, nëpërmjet rënies së *-o-së* së patheksuar dhe evolucionit *tj- > s-* dhe *-éi > -i*. Për format *-sa-* dhe *-so* (tek *a-sa-j, a-so*)

24) Për këtë evolucion shih Meyer, Alb. St. III, 43; E. Çabej, *Hyrje në hist. e gjuhës shqipe*, 120.

Do pasur parasysh se Pedersenit në KZ 36, 313-314 e pranon evolucionin *s-: h-* «para zanoresh të prapme të patheksuara» (!), kurse në Festschrift, 252 e kundërshton mendimin e Meyer-it (Alb. St. III, 43) lidhur me një evolucion të tillë.

ai (po aty) mendonte se mund të jenë reflekse të °tojái, përkatësisht °tojã, kjo e fundit «ndofta nga një më e vjetër °tojái». Edhe në këto dy raste ai presupozonte evolucionin *tj- > s-* (pas rënies së -o-së), si edhe evolucionin -ái > -a, përkatësisht -ã > -o). Edhe format e «rrjedhore» shumës *si-sh, so-sh* ai i shpjegonte me të njëjtën mënyrë nga °tojéisu, përkatësisht °tojásu.

39. Lidhur me këto shpjegime, që Pedersen i ka dhënë si të mundshme, mund të parashtrohen këto vërejtje kritike.

Format °tojéi, °tojái, °tojá (si edhe °tojéisu, °tojásu), të invokuara nga Pedersen, duken si të rindërtuara *ad hoc*; ai nuk i ka krahasuar ato me format rasore përgjegjëse të gjuhëve indoevropiane, që e kanë pasur gjithashtu dëftorin °so, °sã, °tod. Gjithashtu ai nuk sqaron as zanafillën e -j- (tek °tojéi, etj.). Edhe rënia e -o-së (tek °tojéi etj.), qoftë edhe në periudhën pasromake, duhej argumentuar. Përveç këtyre, duhej sqaruar përse -ai (tek °tojái) ka dhënë -a dhe jo -e, ashtu siç pritej (krahaso p.sh. mbaresën rasore -e të emrave femërore njëjës; shih për këtë vërejtjet e mia në «St. fil.» 2, 1973, § 31). E paqartë mbetet edhe forma e rindërtuar °tojá, e «rrjedhore» njëjës të gjinisë femërore, për të cilën Pedersen shton se mund të ketë ardhur «ndofta nga një më e vjetër °tojái.

Vërejtjet e mësipërme vlejné edhe për format e rindërtuara të shumësit °tojéisu dhe °tojasu, që, sipas Pedersenit, kanë dhënë përkatësisht *sish, sosh*.

Për sa i takon formës së rrjedhore *syresh*, që ndeshet aty-këtu, është plotësisht i mbështetur shpjegimi i Pedersenit (Festskrift, 251; KZ 36, 314), i cili shihet këtu «një rishndërtim të qartë sipas gjindores shumës», d.m.th. një kontaminim të formës të rrjedhore (*sish, sosh*) me atë të gjindores (-tyre).

40. Në këto rrethana, ka më shumë të ngjarë që format e dëftorit me nisoren *s-* (*a-si, a-so* e *a-sa-j*) ta kenë burimin tek tema përemërore *t(i)io-*, e afërt me dëftorin °so, °sa, °tod, ashtu siç lë të nënkuptohet Brugmann-i (vep. cit. 351,) i cili pohon se në gjuhën shqipe dhe në gjermanishte «format e °t(i)io- janë shkrirë paradigmatisht me ato të °to-».

Sidoqoftë, mbetet ende i paqartë burimi i zanores -a- (tek *a-sa-j*) dhe -o (tek *a-so*), për të cilat shih vërejtjet përkatëse tek § 39.

41. Për sa u takon formavet të shumësit *si-sh, so-sh*, me sa duket, ato janë rindërtuar nga format e rrjedhore njëjës (*si, so*), duke marrë këto mbaresën rasore -sh të sistemit emëror, (shih për këto forma edhe M. Domi, vep. cit. 29; I. Ajeti, vep. cit. 47; shih edhe § 53 të këtij artikulli).

42. Edhe shpjegimet e dhëna nga Pedersen për formën e shumësit mashkullor *ta* (*a-ta*) dhe për atë të gjindore-dhanores shumës për të tri gjinitë *tyne / tyre* (*a-tyne / a-tyre*). lënë shteg për vërejtje kritike.

Formën e shumësit mashkullor -ta (emërore e kallëzore) ai më parë (KZ 34, 290; shën. 1) e shpjegoi me rezervë nga një formë e kallëzore së gjinisë mashkullore shumës °tons²⁵, më vonë (KZ 36, 315) nga format e emërore dhe kallëzore shumës °toi²⁶, °tons. Kurse tek forma -tyne / -tyre Pedersen (KZ 36, 315) shihet «një mbaresë të dyfishtë», d.m.th. e ndante në *t-yr-e* (geg. *t-yn-e*). Sipas tij, si mbaresa -e, që del në gjindore-dhanoren shumës të emrave edhe e zgjëruar me një -v- kundër hiatit, ashtu edhe mbaresa -yn- / -yr- e gjindore-dhanores së dëf-

25) Ky mendim është pranuar edhe nga Brugmann-i, vep. cit. 221.

26) Mendimi që -ta tek shumësi mashkullor (*a-ta, kē-ta*) është refleksi i °toi është pranuar edhe nga E. Çabej («St. fil.» 2, 1970, 81), i cili e merr këtë si një dëshmi në të mirë të tezës së tij për ndërrim *oi: ai: a* në gjuhën shqipe.

torit e kanë burimin tek mbaresa indoevropiane e gjindores shumë *-ōm*. Ai shton: «Është e vërtetë se zhvillimi i zanores është pak i papritur; *y* nuk mund të jetë shkalla e parë e *e-së* tjetër (shkalla e parë e *e-së* do të ishte më fort një *ō*); por kjo nuk flet kundër asaj që *-ōm* në një fjalë njërrrokëshe (indoevropianishtja *°tōm*) të jetë zhvilluar kështu. Forma e presupozueshme *°tōm* nuk ka qenë forma zanafillëse indoevropiane, por një ndërtim i ri».

43. Forma e shumësit mashkullor *a-ta*, *-ta* nuk mund të jetë as refleksi i emërores *°toi*, as i kallëzores *°tons*.

-oi (tek *°toi*) nuk mund të jepte në gjuhën shqipe *-a*, veçse po të pranohej që fundorja *-i* ka rënë, para se *-oi* të evoluonte më tej, gjë që duhej argumentuar.

Ndryshe mendon E. Çabej (shih shën. 26), i cili pranon vetëm ndërrimin *oi: ai: a* dhe nuk pranon ndërrimin *oi: ai: e* as në trup fjale.

Nga ana tjetër, edhe *°tons* nuk mund të përfundonte në *ta*. Në parim bashkohem me vërejtjen e E. Hamp-it («Gender shift in Albanian» në «Romance Philology», vol. XII, nr. 2 — 1958 — f. 150), se, duke marrë parasysh faktin që forma e kallëzores mashkullore njëjës *të* (*kë-të*) është refleksi i indoevropianishtes *°tóm* (Pedersen, KZ 36, 314; Jokl IF 36, 98 v.), forma e shumësit mashkullor *ta* (*kë-ta*) nuk mund të jetë refleksi i indoevropianishtes *°tons*. Në kushte të barabarta fonetike i njëjti tingull nuk mund të mos pësonte të njëjtin evolucion. Kurse në këtë rast gjendja paraqitet ndryshe. Ndërsa në kallëzoren njëjës të gjinisë mashkullore bashkëtingëllorja hundore ka lënë gjurmë nëpërmjet hundorëzimit të zanores *-a* (nga indoevropianishtja *-o*) dhe kthimit të saj të mëvonshëm në *-ë* në toskërishte (shih § 33), tek forma e shumësit mashkullor (*kë-)**ta* gjurmë të tilla nuk duken gjëkund. Prandaj bashkohem me mendimin e Hamp-it që burimi i dëftorit mashkullor shumë *-ta* duhet kërkuar gjetiu. Por është vështirë të pranohet që kjo formë në origjinë të ketë qenë «ndofta analogjike», siç shprehet ai, sepse në këtë rast lind me të drejtë pyetja se cili ka qenë modeli i kësaj «forme analogjike».

44. Unë mendoj (shih edhe Çështje të sistemit emëror, 122 v.) se *a*-ja e dëftorit shumë mashkullor *-ta* është refleksi i një *-o*-je të theksuar jo të gjatë, që nuk ndiqej nga një bashkëtingëllorë hundore e kjo duhet kërkuar ndofta tek një formë e kallëzores shumë *to-* pas rënies së hershme të mbaresës së kallëzores *-ns*²⁷. Forma e kallëzores *-ta* është shtrirë edhe në rasën emërore; forma e stër-lashtë e kësaj rase *°toi* me diftongun e saj *-oi* nuk mund të jepte *-a* (shih edhe § 43).

45. Edhe për formën *tyne / tyre* mbeten pa sqaruar disa çështje të rëndësishme, sidomos të karakterit fonetik. Para së gjithash, Pedersen nuk sqaron se si ka qenë e mundur që nga e njëjta mbaresë indoevropiane (*-ōm*) të jenë përfutur në gjuhën shqipe dy mbaresa të ndryshme (*-yn-* / *-yr-*, përkatësisht *-e*).

Ky pohim i Pedersenit, që gjer më sot është miratuar vetëm nga S. Riza (Emrat në shqipe, 20-21), del fonetiki i pambështetur edhe sikur të mendohet që *-e* dhe *-yn-* janë përfutur nga *-ōm* në dy pjesë të ndryshme të ligjëratës dhe në dy periudha të ndryshme, të cilat duhet të jenë patjetër të hershme (shih edhe vërejtjet e tjera të këtij paragrafi si edhe shënimin 28).

Veç kësaj, fonetiki është e vështirë të pranohet që indoevropianishtja *-ōm* të ketë dhënë *-yn-* / *-yr-* në gjuhën shqipe. Pastaj mbetet për të sqaruar çësht-

27) Në të mirë të këtij mendimi do të fliste fakti që edhe në sistemin emëror rënia e mbaresës *-ns* të rasës kallëzore shumë i takon një periudhe shumë të hershme (shih për këtë vërejtje e mia në «St. fil.» 2, 1973, § 37).

tja e fundores *-m*, e cila nuk mund të përfundonte në *-n-* / *-r-* në shqipe. Forma e toskërishtes këtu të bën të mendosh se *-n-* tek *tyne* duhet të jetë ndodhur në pozicion intervokalik në kohën kur ligji i rotacizmit s'kishte pushuar së vepruari në dialektin jugor, d.m.th. para kontakteve të shqipes me sllavishten. Në këtë rast duhej sqaruar arësyeja përse fundorja *-m* e mbaresës *-ōm* qenka alternuar që heret në *-n* në gjuhën shqipe²⁸. Gjithashtu mbetet për të sqaruar edhe arësyeja e shtimit të mbaresës së dytë-*e* të gjindores shumë të emrave që në kohë relativisht të hershme.

Prandaj lidhur me sqarimin historik të formës së gjindore-dhanores shumë të përemrit dëftor të shqipes mund të pohohet vetëm që ajo e ka burimin tek tema e dëftorit indoevropian më *-t*.

Mendimi i P. Skokut (Arhiv za Arbanasku starinu, III/1-2, 166) që tek *a-tyne/a-tyre ty-* të ketë qenë forma e emërores shumë «sot e zhdukur» dhe *-ne* «gjindore-dhanorja shumë e përemrit dëftor indoevropian të sllavishtes *онъ: (o)nōm* > *-ne*», është i paargumentuar dhe i pambrojtshëm.

46. Siç del edhe nga sa u shtjellua në §§ 28-45, teoria e Pedersenit mbi burimin e përbashkët të të gjitha formave rasore të dëftorit të shqipes (për të tria gjinitë dhe për të dy numrat) në përgjithësi paraqitet e mbështetur. Por në disa pika të veçanta, si p.sh. për formën e rasës emërore, njëjës e shumë, të gjinisë mashkullore, për format rasore me *s-*, për formën e gjindore-dhanores shumë, etj. sqarimet e Pedersenit nuk arrijnë t'u mbyllin shtigjet vërejtjevet kritike, sepse nuk mbështeten nga të dhënat e fonetikës e të morfologjisë historike të shqipes.

47. Siç u vu në dukje edhe në § 3, tipare arkaike lakimi vihen re edhe në paradigmen e përemrit pyetës *kush* — alternimi *-u-* : *-ē* si edhe prania e fundores *-sh* tek forma e emërores (*ku-sh, ku-jt, kë*).

Lidhur me burimin e këtij përemri sot mbizotëron mendimi i Pedersenit (KZ 36, 317), që e lidhte me përemrin pyetës indoevropian **kwo*²⁹ (shih për këtë E. Çabej, «St. fil.» 1, 1964, 89, me literaturë). Është pranuar gjithashtu si i drejtë shpjegimi i Pedersenit që tek forma e dhanores *ku-jt* temës *ku-* i është shtuar

28) Me sa duket, Pederseni ka menduar që tingulli fundor i kësaj mbarese indoevropiane në protoshqipen ka kumbuar *-n* (ashtu si në greqishten e vjetër) dhe jo *-m*, sepse, përndryshe, nuk kishte si të përftohej *-n-ja* tek *-yn-*. Por, nga ana tjetër, dihet se fundorja *-on* në gjuhën shqipe i është nënshtruar një procesi relativisht të hershëm evolucioni, që ka përfunduar në togun zanor toskërisht *-ua*, gegërishte *-ue*, si tek *krua* / *krue* etj. (shih për këtë Jokl, IF 49, 274 v.). Prandaj mungesa e diftongimit të *-ō-së* dhe ruajtja e *-n-së* si edhe rotacizmi i saj në toskërishte të bëjnë të pranosh se *-n-* tek *tyne* është ndodhur në pozicion intervokalik që në kohë relativisht të hershme.

29) G. Meyer-i (Der Einfluss des Lateinischen auf die albanesische Formenlehre, në vëll. Miscellanea Caix-Canello, 107; Gröbers Grundriss I, 820; EW 217 v.) ka shprehur mendimin se *kush* është refleksi i përemrit pyetës latin *quis* (në EW 218 këtë mendim ai e jep me rezervë). Duke qenë se lat. *quis* në gjuhën shqipe nuk mund të jepte *kush*, sepse *qu* para *-i* duhej të jepte *q-* dhe fundorja *-s* duhej të kish rënë prej kohësh (kjo e fundit nuk ka lënë gjurmë as në gjuhët neolatine), tek *ku-* e formës *kush* ai shihte një veprim analogjik të mundshëm nga forma e dhanores *kuj(t)*, të cilën ai e lidhte drejtpërdrejt me gjindoren latine *cuius*. Kurse ruajtjen e fundores *-sh*, sipas tij prej lat. *qui-s*, ai e shpjegonte «me anë të fonetikës së fjalisë» (Der Einfluss des Lateinischen, 107; EW 218).

Lidhur me këto shpjegime të Meyer-it nuk mund të mos bëhen vërejtjet e mëposhtme: Është vështirë, në mos e pamundur të mendohet që forma e gjindores *kuj(t)* të ketë ndikuar mbi atë të emërores (ndikimi i anasjelltë është shumë më i mundshëm) diftongu *ui-* i latinishtes *cui-us* vështirë se mund të ishte ruajtur i pandryshuar në shqipe. Edhe shpjegimi për ruajtjen e fundores *-sh* te *ku-sh* «me anë të fonetikës së fjalisë» nuk sqaron gjë në këtë mes.

mbaresa rasore e gjindore-dhanores *-i* dhe nyja e prapme *-t*. Edhe Meyer-i (EW 217) pat shprehur një mendim të ngjashëm për fundoren *-t* tek *kujt* (shih për këtë formë edhe M. Domi, vep. cit. 31; I. Ajeti, vep. cit. 52).

48. Refleksi i temës së cilës forme rasore është kjo *ku-*, që del si në rasën emërore ashtu edhe në dhanore (*ku-sh*, *ku-jt*), mbetet për t'u sqaruar, ashtu siç mbetet për t'u sqaruar edhe fundorja *-sh* e rasës emërore. Për sa i takon temës *ku-*, këtu vështirësia qëndron tek zanorja *-u*, sepse dihet që si guturalet e thjeshta indoevropiane (*k*, *g*), ashtu edhe labiovelaret (*g^u*, *g^u*) para zanorevet *-a*, *-o*, *-u* në gjuhën shqipe janë reflektuar me *k-*, *g-*. (shih E. Çabej, Hyrje..., 108, 110).

Për sa i takon fundores *-sh* (tek *ku-sh*), mendimi i Pedersenit (KZ 36, 317) që ajo «duhet të jetë mbeturina e një elementi përemëror që s'mund të përcaktohet më afër», e lë prapë të pazgjidhur problemin.

Për Bopp-in, vep. cit. 463, fundorja *-sh* tek *ku-sh* mund të jetë mbaresa shumë e vjetër e rasës emërore. Ai e krahason këtë përemër të shqipes me *ka-s* të sanskritishtes dhe të lituanishtes si edhe me *kvas* të gotishtes. Ky supozim i Bopp-it nuk ka gjetur miratim, qoftë edhe për arësyen e thjeshtë se një *-sh* fundore, e dalë nga një *-s*, nuk mund të ishte ruajtur në gjuhën shqipe (shih edhe shënimin 29). Megjithatë, ai nuk duhet hedhur poshtë patjetër. Nuk duhet përjashtuar mundësia që kjo «mbaresë» e shqipes të mos jetë ndodhur në pozicion fundor, ashtu siç supozon edhe E. Çabej, «St. fil.», 1, 1964, 90, për të cilin «*kush* ka qenë dikur dysillabike ashtu si *kur* e si *mos*. Mbase e krahasueshme nga ajo anë me tokar. B *kus^e*, *ksa*, *kse*, përemër pyetës, i pacaktuar e lidhor, për të cilin shih Meillet IJ I, 13. Ose trajta bisillabike u sajua përbrenda shqipes, veçse ajo në çdo rasë duhet të jetë e vjetër».

49. Më e qartë historikisht paraqitet forma e kallëzores *kë*, ku fundorja *-ë* është refleksi i një *-a*-je hundore. Pra *kë* ka dalë nga një **kan* e kjo mund të lidhet natyrshëm me një formë parashqiptare të kallëzores **quom* a **kom*³⁰, nëpërmjet evolucionit të njohur *o: a* (krahaso edhe *a-të* të gjinisë mashkullore (§ 33)).

Ky shpjegim më duket më i mbështetur se ai i Joklit (IF 36, 99), që si formë përgjegjëse të toskërishtes *kë* për gegërishten jep *kë* (me *e* hundore), ashtu sikurse *atë* e jep si formë përgjegjëse të toskërishtes *atë*. Edhe M. Domi (vep. cit. 31) jep këtë skemë evolucioni: **kuo-m > *ke-n > *kê, kë*, por pa sqaruar se si nga **kuo-m* ka dalë **ke-n*. Format gege *atë*, *kë* janë relativisht të reja; më të vjetra janë format *a-të* (shih për këtë § 33) dhe *ka* (n), siç na dëshmojnë trajtat *kana*, *askana*, *gjithëkana* të Buzukut, *gjithëkand* etj. (shih për këto trajta E. Çabej, BUSH, SShSh 4, 1963, 93).

Nga ana tjetër, bashkohem me kritikën e Joklit (IF 36, 99) kundër shpjegimit të Meyer-it, sipas të cilit (Alb. St. III, 88) *-ë* tek *kë* është refleksi i një *o*-je të patheksuar të një fjale njërrrokëshe.

50. Pra, sqarimi historik i formave rasore të përemrit pyetës *kush* paraqit vështirësi, që pjesërisht janë ende të pakapërcyera. Sidoqoftë, këto forma rasore

30) Shih për këtë formë të rindërtuar Pedersen, KZ 36, 317; M. Domi, vep. cit. 31; E. Çabej, «St. fil.» 1, 1964, 89; I. Ajeti, vep. cit. 52.

Mendimin që *kë* është refleksi i formës së kallëzores **kom* të indoevropianishtes e pat shprehur më parë Meyer-i Alb. St. III, 2, 88; EW 217). Më parë në Der Einfluss des Lateinischen, 107, ai pat shprehur mendimin që *kë* (geg. *kë*) është refleksi i latinishtes *quem*; kjo, shton ai, duhej të jepte *që* (geg. *që*), por nën ndikimin e dhanores *kuj(t)* përfundoi në *kë* (geg. *kë*). Këtë mendim ai nuk e mban për të pamundur edhe EW 217.

paraqisin tipare arkaike të një lakimi *sui generis*, që nuk kanë shoq në tërë sistemin e lakimit të shqipes së dokumentuar.

II

51. Siç u vu në dukje në § 2, në lakimin e një numri të konsiderueshëm përmrash vihet re një ndikim jo i parëndësishëm nga lakimi i emrave dhe i mbiemrave.

Ndikimi i lakimit të emrave mbi atë të disa përmrave është një dukuri e kuptueshme, po të kihet parasysh lidhja e ngushtë kuptimore midis këtyre dy klasave fjalësh si edhe paralelizmi pothuaj i plotë midis tyre në funksionet sintaksore. Këtu është fjala për funksionet sintaksore të atyre përmrave, që nuk përdoren në bashkëvjajtje me emra. Për këtë arsye edhe në gjuhë të tjera indoevropiane lakimi i përmrave është ndikuar nga ai i emrave dhe anasjelltas³¹.

Ndikimi i lakimit të emrave mbi atë të përmrave në gjuhën shqipe ka qenë ose i drejtpërdrejtë, ose i tërthortë nëpërmjet lakimit mbiemëror. Në rastin e fundit është fjala për kalimin e disa mbaresave rasore emërore tek disa përmra nëpërmjet ndikimit të lakimit mbiemëror (shih §§ 55-62).

52. Ndikimi i drejtpërdrejtë i lakimit emëror mbi atë të disa përmrave konsiston në kalimin e disa mbaresave rasore të emrit tek disa përmra të përdorur në funksion emëror. Kështu p.sh. tek format e rrjedhës njëjës të përmrave vetorë *me-je*, *te-je* (shih edhe § 11, 23), siç e ka vënë në dukje M. Domi, vep. cit. 25, 26, mbaresa rasore *-je* ka kaluar këtu nga emrat femërorë³². Këtë mbaresë rasore të emrave femërorë e gjejmë edhe tek rrjedhja e vetorit (me origjinë dëftori) *so-je* si edhe të pyetësit *se-je*, siç na dëshmon për këtë të fundit vepra e Budit.

P.sh. në DC 179:

Përse s'shtie të kujtuom

Nceje [= *n seje*] jë krijuom.

Por Buzuku këtë përmër në rasën rrjedhore e përdor në formën *sej* [= *se-i*] me mbaresën *-i* të lakimit të parë. P.sh. E ata tue stripunë n malit, i ordhënoi Jezu kujnaj gjā mos thoshnë n *sej* panë... «Et descenditibus illis de monte, praecepit eis Jesus, dicens: Nemini dixeritis visionem...»... tue thashunë: Qish të hamë, o qish të pīmë, o n *sej* na të nvishemi? «...dicentes: Quid manducabimus, aut quid bibemus, aut quo operiemur?» («Meshari» LXXXVIII [=98] / bis, LXXVII [=87] / bis.

Me përjashtim të *se-je*, ku mbaresa *-je* e dallon formalisht rrjedhoren nga forma *se* e rasave emërore e kallëzore, tek *me-je*, *te-je* dhe *so-je*, mbaresa *-je* është hiperkarakterizuese, sepse vetë format *me-*, *te-* dhe *so-* mjaftonin për të dalluar formalisht rrjedhoren nga format e rasave të tjera.

31) «Në përgjithësi rruga e historisë së gjuhëveve indoevropiane, me sa mund të vështrohet kjo në mënyrë retrospektive, tregon se rrafshimi i ndryshimeve lakimore ndërmjet emrit dhe përmrit ka qenë shumë më i madh se sa krijimi i ndryshimeve të tilla të reja». (Brugmann, vep. cit. 307 v.). Ky autor pastaj jep raste konkrete të ndikimit reciprok midis lakimit emëror dhe përmëror.

32) Këtë shpjegim të Domit, që e gjejmë së pari tek Meyer-i, *Alb.St.* III, 89, e përmendim edhe E. Çabej, «St.fil.» 2, 1966, 74, si edhe I. Ajeti, vep. cit. 42, 43.

53. Edhe tek format e shumësit *ne-ve*, *ne-sh*, *ju-ve*, *ju-sh*, duket qartë ndikimi i lakimit të emravet, gjë që e kanë vënë në dukje edhe La Piana (Intorno al riflesso della vocale «o» lunga dall'Indoeuropeo e dal Latino nell'Albanese, f. 14 — vetëm për mbaresën *-ve*), M. Domi (vep. cit. 26) dhe I. Ajeti (vep. cit. 43). Këtu do shtuar se mbaresa rasore *-ve* ka kaluar nga lakimi i emravet edhe tek përemrat e pacaktuar *ca-ve*, *disa-ve*, (të) *gjithë-ve*, *të tërë-ve*, *shumë-ve*, *pakë-ve* si edhe tek pyetësi *sa-ve*³³. Mbaresa rasore *-ve* ndeshet rregullisht edhe tek përemri i pacaktuar shumës *të tjerë*, në përdorim të substantivuar (*të tjerë-ve*, *të tjera-ve*). Në një fazë më të vjetër me këtë përemër përdorej edhe forma e rrjedhore *së tjerësh* (*së tjerash*).

Siç u vu në dukje edhe në § 41, ka shumë të ngjarë që edhe tek format *si-sh*, *so-sh* mbaresa rasore *-sh* ta ketë burimin nga lakimi i emravet,

54. Edhe tek forma e gjindore-dhanores së përemrit pyetës *kush* duket qartë ndikimi i lakimit emëror. Tek forma *kujt*, e analizueshme në *ku-i-t*, siç e sqaroi së pari Pedersen (KZ 36, 317), temës përemërore *ku-* i janë shtuar mbaresat *-i* dhe nyja e prapme *-t* të rasavet gjindore-dhanore të emravet (shih edhe § 47). Kjo vërejtje vlen edhe për të gjithë përemrat e pacaktuar të tipit *kushdo* apo *ndokush*, që kanë në përbërjen e tyre përemrin *kush*.

55. Ndikimi i lakimit të emravet duket qartë edhe tek format rasore të përemrit pyetës *cili* dhe të lidhorit *i cili*. Lakimi i këtyre dy përemrave është i njëjtë, në gjininë mashkullore, me atë të lakimit të emravet të tipit *gur-i* (në trajtë të shquar) dhe, në gjininë femërore, me atë të emravet të tipit *fush-a* (gjithashtu në trajtë të shquar). Të krahasohen p.sh. *cili*, *cilit*, *cilin*, *cilët*, *cilëve* (*t*) me *guri*, *gurit* *gurin*, *gurët*, *gurëve*(*t*); dhe *cila*, *cilës*, *cilën*, *cilat*, *cilave*(*t*) me *fusha*, *fushës*, *fushën*, *fushat*, *fushavet*(*t*).

Por lidhur me lakimin e këtyre dy përemrave mund të mendohet më fort për një ndikim të tërthortë të lakimit emëror, dhe pikërisht nëpërmjet lakimit të mbiemravet të substantivuar. Kjo del e qartë sidomos po të mbahet parasysh fakti që këta përemra, ashtu si mbiemrat, përshtaten në gjini me emrat, të cilëve u referohen, dhe këtë përshtatje në shumën e shprehin nëpërmjet kundërvënies së mbaresavet të shumësit *-ë* : *-a*- (krahaso të *mirë-t* : të *mira-t*).

56. Ndikimi i tërthortë i lakimit emëror nëpërmjet lakimit të mbiemravet të substantivuar del edhe më e qartë në lakimin e pronorëvet të substantivuar, d.m.th. kur ata nuk përdoren në bashkëvjatje me emra³⁴ (si p.sh. *im-i*, *tim-it*, *tim-in* etj.) si edhe në lakimin e përemrit të pacaktuar *tjetër*, përdorur gjithashtu i substantivuar. Pronorët, siç dihet, të substantivuar përdoren vetëm në trajtë të shquar (shih për këtë Sh. Demiraj, Çështje të sistemit emëror, 40 v.) sipas paradigmes së lakimit të parë, përkatësisht të tretë, për gjininë mashkullore, përkatësisht femërore. Kurse i pacaktuari *tjetër*, i substantivuar, përdoret në të dy trajtat (shih për këtë Sh. Demiraj Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II.

33) Do pasur parasysh se format *save* (aty-këtu edhe më *sash*), *shumëve* dhe *pakëve* ndeshen shumë rrallë. Tek Buzuku ndeshet edhe forma e rrjedhore më *-sh*, si p.sh. *q shumësh* («Me shari» LXXXIV [=94]). Të kihet parasysh edhe forma e përemrit të pacaktuar (para) *së-gjithash*.

34) Në një fazë më të vjetër, siç na dëshmon vepra e Buzukut etj., pronorët, ashtu si mbiemrat (shih për këta «St.fil.» 2, 1973, §§ 65-67), edhe kur përdoren pas emravet, sidomos në numrin shumës, mund të merrnin mbaresat rasore, si p.sh. tek Buzuku: . . . e tha një *q* di-shipujshit *së tish*. . . . e për të pëligjet të përinde *tinëve*. . . («Meshari» LVI [=66], XLVII).

152 v.), sipas paradigmës së lakimit të parë, përkatësisht të tretë, për gjininë mashkullore, përkatësisht femërore.

Këto vërejtje vlejnë edhe për dëftorin *i tillë*, të substantivuar; por do pasur parasysh se ky përemër, i substantivuar përdoret më fort në trajtë të pashquar (shih Sh. Demiraj, Morfologjia, II, 122 v.).

57. Në lakimin e disa përemrave të shqipes duket qartë ndikimi i drejt-përdrejtë i lakimit mbiemëror. Këtu është fjala për ata përemra, që për nga tipi strukturor paraqiten të njëjtë ose të ngjashëm me mbiemrat e nyjshëm, siç janë dëftori *i tillë* (a *i këtillë* / *i atillë*), pronorët *i tij*, *i saj*, *i vet*, *i tyre*, *e mi*, *e tu* si edhe pyetësit *i sejtë* dhe *i sati*. Në këtë grup hyn historikisht edhe përemri i pacaktuar *tjetër*, i cili, siç e sqaroj së pari Meyer-i (EW 162) e pas tij Pedersen-i (Philologica II, 112), në numërin njëjës ka dalë nga përngjitja e nyjes së përparme *t(ë)* me trupin e përemrit *-jetër* (shih për këtë edhe M. Domi, vep. cit. 32/3; E. Çabej, «St. fil.» 2, 1966, 81; I Ajeti, vep. cit. 54). Në këtë grup mund të përfshihet, për nga tipi strukturor, edhe përemri pyetës *i sati*³⁵, si dhe përemri lidhor *i cili*, që paraqiten gjithashtu të paranyjzuar.

58. Për sa i takon lakimit të «nyjes së përparme» tek dëftori *i tillë* dhe tek pronorët *i tij*, *i saj*, *i vet*, *i tyre*, *e mi*, *e tu*, si edhe tek pyetësit *i sejtë* dhe *i sati*, do pasur parasysh se këtu kemi të bëjmë me një dukuri të njëjtë me atë të mbiemrit të nyjshëm, me të cilin përemrat e lartpërmendur kanë të përbashkët edhe përdorimin e tyre si kallëzuesorë dhe si përcaktorë me përshtatje të emrit. Prandaj ruajtja e lakimit të «nyjes së përparme» tek këta përemra e gjen shpjegimin e vet në faktin e njohur që «nyja e përparme», megjithëse pjesë përbërëse e tyre, ashtu si tek mbiemri i nyjshëm, nuk i ka kuptuar lidhjet gjenetike me emrin, me të cilin përshtatet jo vetëm në rasë, por edhe në gjini e numër.³⁶

59. Dëftori *i tillë*³⁷ takohet me mbiemrin edhe në funksionet sintaksore. Ashtu si mbiemri, edhe ky dëftor, kur nuk është në bashkëvajtje me emrin, përdoret vetëm në funksion kallëzuesor (si kallëzues emëror dhe si plotës kallëzuesor i kryefjalës e i kundrinës), pra vetëm në rasat emërore dhe kallëzore. E në këto dy rasa, jo vetëm mbiemri, por edhe emri i ka humbur prej kohësh mbaresat rasore (shih «St. fill.» 2, 1973, §§ 28-29). Prandaj ashtu si mbiemri, edhe dëftori *i tillë* në funksion kallëzuesor del pa donjë mbaresë rasore.

60. Edhe përemri pyetës *i sejtë* përdoret vetëm në funksion kallëzuesor, d.m.th. vetëm në rasat emërore dhe kallëzore. Si rrjedhim, edhe ky përemër, ashtu si dëftori *i tillë*, lakon vetëm «nyjen e përparme» dhe nuk merr ndonjë mbaresë rasore.

61. Tek përemri pyetës *i sati* dhe tek lidhori *i cili* lakimi i «nyjes së përparme»

35) Ky përemër, i cili lidhet me rrjeshtorët si për nga struktura ashtu edhe për nga kuptimi përdoret rregullisht në trajtë të shquar, ashtu si rrjeshtorët, kur nuk janë në bashkëvajtje me emra.

36) Këtu nuk është rasti të ndalem në çështjen aq të diskutuar mbi zanafillën e «nyjes së përparme» të shqipes, çështje që e kam trajtuar pak më gjërë në tekstin *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, I.

37) Për origjinën e këtij përemri shih sidomos E. Çabej, «St. fil.» 2, 1966, 75, si edhe *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, 175.

siç dihet, nuk ndryshon nga ai i «nyjes së përparme» të një mbiemri të substantivuar të tipit *i miri : e mira*. Lakimi i këtyre dy përemrave nuk ndryshon fare nga i mbiemrit të substantivuar të tipit *i miri / e mira* (në trajtë të shquar) edhe për sa u takon mbaresavet rasore dhe nyjevet shquese.

62. Siç u vu në dukje edhe në § 57, historikisht është i paranyjzuar edhe përemri i pacaktuar *tjetër* (nga *t + jetër*), i cili, ashtu si *i tillë*, kur nuk është i substantivuar, takohet me mbiemrin edhe në funksionet sintaksore (shih § 59). Ky përemër në shqipen e sotme në njëjës paraqitet i palakueshëm, kurse në shumës tek forma e paranyjzuar *të tjerë* nyja e përparme pëson të njëjtat ndryshime (*të : e*) si tek mbiemrat e nyjshëm në këtë numër. Por në një fazë më të vjetër të gjuhës, siç na dëshmon vepra e Buzukut, ky përemër edhe në njëjës e lakonte «nyjën e përparme» të parangjitur, e cila në rasën rrjedhore merrte formën arkaike *s-* (nga *së*). Formën arkaike të rrjedhores *së* e merrte «nyja e përparme» e këtij përemri edhe në numrin shumës, ashtu si edhe tek mbiemrat e nyjshëm.

Format e sotme të shumësit të këtij përemri (mashk. *të tjerë*, fem. *të tjera*) nuk ndryshojnë aspak nga ato të mbiemrave të tipit *i mirë* (khs.: *të mirë / të mira*). Edhe mbaresat e shumësit *-ë* dhe *-a* tek ky përemër kanë kaluar nga mbiemrat e nyjshëm. Prandaj këtu sa për ilustrim, po japim disa shembuj të këtij përemri vetëm në rasën rrjedhore njëjës, nxjerrë nga vepra e Buzukut.

... përse u thashë sjetëre herë... ; ... por hën për sjetër ane... Danī pleqtë njanë n sjetërit. ... ashtu atëherë vetë ndë vetëhenë të ketë me se të ketë lavd n madhështie e jo n sjetëri («Meshari», XVII, LXX [=80]/bis, LIV/bis, LXXVII [=87] / bis).

III

63. Siç u vu në dukje edhe në § 2, tek disa përemra të krijuar gjatë zhvillimit historik të shqipes janë përfutur tipare të reja lakimi. Këtu është fjala për:

1) Pronorët e tipit *im*.

2) Përemrat e pacaktuar *kushdo* dhe *cilido*.

Tek përemrat e lartpërmendur, që janë të përbërë prej dy elementesh, lakohet elementi i parë. Pra, këtu kemi të bëjmë me një tip lakimi *sui generis*, krejt të ndryshëm nga lakimi i trashëguar indoevropian, ku dallimet rasore realizohen nëpërmjet mbaresavet.

Një tip i tillë lakimi nuk është i panjohur edhe në disa gjuhë të tjera indoevropiane, ku, ashtu si në gjuhën shqipe, ai është përfutur gjatë zhvillimit historik të tyre, si p.sh. në greqishte të vjetër tek përemrat *ὁ-δε, ἡ-δε, το-δε* «ky, kjo, këta». Për formime përemërore të këtij tipi në gjuhë të ndryshme indoevropiane, si në latinishte, keltishte, gjermanishte, bullgarishte të vjetër, indishte të vjetër etj. shih, ndër të tjerë, Hirt, vep. cit. 28.

64. Tek pronorët *im/ime* (me përjashtim të formës së shumësit *e mi/e mio* — shih § 14-15), *ynë/jonë*, *yt/jote* (me përjashtim të formës së shumësit *e tu*)

etua — shih § 22) dhe *yj*³⁸/*juaj*³⁹ elementi i parë përshtatet me emrin, që tregon «pronën» në gjini, numër e rasë, ashtu siç ndodh me «nyjen e përparme» të mbiemrave të nyjshëm. Për paradigmen e ndërlikuar të pronorëve në një fazë më të vjetër. të shqipes (si p.sh. tek Buzuku etj.) shih S. Riza, BUSHT, SSSH 3, 1959, 40-48; I. Ajeti, vep. cit. 50-51.

65. Në pamundësi që të merrem këtu me problemin aq të diskutuar lidhur me zanafillën e këtij elementi të parë të pronorëve⁴⁰, do të vë në dukje vetëm konstatimin e njohur që format rasore të këtij elementi përkojnë në përgjithësi me ato të përmrit dëftor pa parashtesën deiktike *a-*, përkatësisht *kë-*.

Pronorët e përngjitur, ashtu si gjithë fjalët e tjera të përngjitura, kanë qenë dikur të papërngjitur. Atëhere elementi i tyre i parë ka pasur një mëvetësi formale, të cilën e ka ruajtur edhe pas përngjitjes me elementin e dytë. Një rol të rëndësishëm në këtë rast do të ketë luajtur edhe fakti që elementi i dytë i pronorit, pas gjithë gjasash, ka qenë i palakueshëm⁴¹, si edhe fakti tjetër që elementi i parë ka qenë i theksuar. Në rast se elementi i parë i pronorëve në shqyrtim ka qenë përemër dëftor, ky e ka ruajtur theksin e vet. Por, në rast se ai ka qenë «nyje e përparme», kjo nuk mund të ketë qenë e theksuar. Prandaj, në rast se elementi i parë ka qenë «nyje», atëhere duhet pranuar që kjo ka tërhequr theksin mbi vete në bazë të ligjit të rregullimit mekanik të theksimit (shih për këtë W. Meyer-Lübke, Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität Wien, I 20-21; Jokl, IF 36, 119-120).

38) Për këtë përemër të vetës së dytë shumë të gjinisë mashkullore (*yj* < *y + u + j*) shih S. Riza, BUSHT, SSSH 3, 1959, 13.

39) Për këtë përemër të vetës së dytë shumë, në zanafillë të gjinisë femërore (*juaj* < *jo + u + j*) shih Jokl, IF 49, 275 v.

40) Për pronorët e dy vetave të para (me përjashtim të formave të shumësit *e mi*, *e tu*) që nga Bopp-i (vep. cit. 520 v., vërejtja 2 për shën 18 të f. 466) e këtej është pranuar nga të gjithë se ato përbëhen prej dy elementesh të përngjitur prej kohësh. Por pyetjes se ç'kanë qenë në zanafillë këto dy elemente, i janë dhënë dy përgjigje të ndryshme:

Sipas Bopp-it, Kamardës (vep. cit. 219 v.), Mjedës (Vërejtje mbi artikuj e premna pronës të gjuhës shqipe, 24 v., 31), dhe Çabejt (BUSHT, SSSH 3, 1963, 77 v.), elementi i parë ka qenë përemër dëftor, kurse elementi i dytë ka qenë përemër vetor në rasën «gjindore».

Por sipas Pedersenit (KZ 35, 311), Brugman-it (vep. cit. 403), Joklit (IF 49, 274), La Pianës (St. ling. alb. II, 70), S. Rizës (BUSHT, SSSH 3, 1959, 3 vv.) etj., elementi i parë i këtyre pronorëve ka qenë nyje, kurse elementi i dytë ka qenë përemër pronor.

Në të mirë të hipotezës së parë do të fliste fakti që elementi i parë i këtyre fjalëve është i theksuar, kurse nyjet *si të tilla* nuk mund të mbeteshin të theksuara dhe, si rrjedhim, nuk mund të ruanin trajtat e vjetra rasore. Por, nga ana tjetër, kjo hipotezë nuk arrin të shpjegojë përse shqipja, ndryshe nga gjithë gjuhët e tjera indoevropiane, për të krijuar disa forma pronorësh, paska bashkuar format e vjetra të dëftorit me gjindoren e përmrave vetorë të dy vetave të para.

Në të mirë të hipotezës së dytë do të fliste fakti që «nyja e përparme» si një element fjalëformues dhe trajtëformues është e njohur në gjuhën shqipe. Ajo u është shtuar, ndër të tjera, edhe pronorëve *mi*, *tu* në kohë më të vona (shih §§ 14-15, 22).

Siç del edhe nga këto vërejtje të përmbledhura, asnjëra nga të dy hipotezat e lartëpërmendura nuk del plotësisht bindëse. Ato gjithashtu nuk arrijnë t'i sqarojnë të gjitha vështirësitë, që paraqisin format e pronorëve në fjalë. Mjafton të përmendim këtu ndryshimin e elementit të parë tek *y-t* / *jo-t-e*, nga njëra anë, dhe *i-m* / *i-m-e*, nga ana tjetër. Të kihet parasysh edhe *i-m* përkundrejt *y-në*.

Pra, çështja e gjenezës së pronorëve të shqipes për dy vetat e para mbetet e hapur. Në këtë çështje, që e kam trajtuar pak më gjërë në librin Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I, shpresoj të ndalem më gjatë në një rast tjetër.

41) Kjo hipotezë paraqitet më e mundshme, në rast se elementi i dytë i këtyre pronorëve ka qenë forma e gjindores së përmrave vetorë përgjegjës.

66. Pyetjes se kur ka përfunduar procesi i përngjitjes së pronorëvet në shqyrtim, është vështirë t'i jepet një përgjigje e prerë. Një sërë faktesh gjuhësore flasin për një moshë relativisht të vjetër të tyre. Ndër këto mund të përmenden: 1) mungesa e parashtesës deiktike tek elementi i parë; 2) ruajtja e *-n-së* së elementit të parë tek forma e kallëzores *tan-d*⁴² dhe evolucioni *-a- : -ë-* para *-n-* në toskërishte (*tën-d*); 3) reduktimi i diftongjevet *-au-*, *-yu-*, *-iu-*, përkatësisht në *-a-*, *-y-*, *-i-* tek format *taj*, *tij*, *saj*, *sij* (përkatësisht nga ^o*tauj*, ^o*tiuj*, ^o*sauj*, ^o*siuj*)⁴³ 4) theksimi i elementit të parë si tek *sot*, *sonte* etj.; shih për këtë dukuri E. Çabej, Hyrje, 92.

Por mungesa e rotacizmit në toskërishte tek forma të tilla si *ynë*, *jonë*, *tanë*, *ton-a* (tek Buzuku *tonë*) si edhe mungesa e alternimit *-a- : -ë-* në toskërishte tek forma e shumësit mashkullor *tanë*⁴⁴ (p.sh. djemtë *tanë*) do të flisnin për një risi relative të pronorëvet të tipit në shqyrtim. Për këto arsye mund të supozohet se përngjitja e *plotë* e të dy elementeve të pronorëvet të tipit në shqyrtim do të jetë përfunduar, pasi kishte pushuar së vepruari në toskërishte ligji i rotacizmit si edhe ai i alternimit *-a- : -ë-* para bashkëtingëlloreve hundore.

Ndryshe e shpjegon E. Çabej mungesën e rotacizmit tek këto forma pronorësh në dispensën e cituar, 116, ku ai pohon: «Duket se *n-ja* u ka ruajtur për hir të sistemit gramatikor».

67. Siç del edhe nga sa u parashtrua në §§ 64-66, pronorët e shqipes për nga tipi strukturor nuk janë homogjenë. Format e tyre për vetën e tretë, njëjës e shumë, dalin të paranyjzëzuar. Të paranyjzëzuar dalin sot edhe format e shumësit të vetës së parë njëjës (*e mi*) dhe të vetës së dytë njëjës (*e tu*), por këto dikur kanë qenë pa «nyje të përparme» (shih §§ 14-15, 22). Kurse në gjithë rastet e tjera kemi të bëjmë me forma fjalësh të përngjitura me një lakim *sui generis*.

Ky diferencim strukturor në format e pronorëvet të shqipes e ka burimin në faktin që ato janë përfutur në kohë të ndryshme. Një periudhe më të vjetër duhet t'i përkasin format *mi*, *tu*, që, siç u shtjellua në §§ 14-15 dhe 22, do të jenë gjindore të vjetra të përemraveve vetorë, përkatësisht të vetës së parë e të vetës së dytë njëjës; prandaj këto forma në një fazë më të vjetër paraqiten me një strukturë të thjeshtë. Format e pronorëvet të tipit *im* (*tim* etj.), që kanë dalë nga përngjitja e dy elementeve (shih shën. 40), i përkasin një periudhe relativisht më të vonë. Por ky tip strukturor është patjetër më i hershëm se ai i formave të vetës së tretë (*i tij*, *i saj*, *i tyre*, *i vet*), ku elementi nyjor nuk është shkruar me trupin e përemrit.

68. Ky shtresëzim kronologjik i tormave të pronorëvet të shqipes është produkt i zhvillimit të brendshëm të kësaj gjuhe. Se si ka qenë paradigma e pronorëvet të shqipes së lashtë, para se të fillonte procesi i krijimit të sistemit, që njohim sot, nuk mund të thuhet asgjë me siguri. Por, duke u mbështetur në format, sipas meje, arkaikë *mi*, *tu*, si edhe në sistemin e pronorëvet të gjuhëvet të

42) Shih për këtë Pedersen KZ 36, 314, shih edhe shën. 23.

43) Shih për këto forma S. Riza, BUShT, SShSh 3, 1959, 13; I. Ajeti vep. cit. 50. Për *tāj* (*ta + u + j*) shih më parë Joklin IF 49, 276, shën. 1.

Siç dihet, format e pronorit të vetës së dytë shumë *taj* (emërore kallëzore e gjinisë asnjëse njëjës dhe e gjinisë mashkullore shumë), *tij* (gjindore-dhanore e gjinisë mashkullore dhe asnjëse njëjës), *saj* (gjindore-dhanore e gjinisë femërore njëjës) dhe *sij* (rrjedhore e gjinisë mashkullore dhe asnjëse njëjës), që ndeshen ende tek autorët e vjetër të Veriut, janë zhdukur prej kohësh.

44) Për sa i takon formën së kallëzores njëjës, mashkullore e femërore, *tënë* (nga *tanë*), këtu alternimi *a:ë* në toskërishte i takon vetë formës së kallëzores së dëftorit (shih për këtë § 33).

tjera indoevropiane (shih shën. 16), mund të pranohet mendimi i shprehur nga Pedersen (KZ 36, 311), Kamarda (Saggio, 220-221), La Piana (St. ling. alb. II, 70), S. Riza (BUSHT, SShSh 3, 1959, 4 v.) që në një periudhë më të lashtë gjuha shqipe (a protoshqipja) ka pasur një sistem pronorësh me *strukturë të thjeshtë* mbiemërore.

69. Por gjatë zhvillimit historik të shqipes, sidomos gjatë këtyre tre-katër shekujve të fundit paradigma aq e ndërlikuar e pronorëvet nuk kish si t'i shpëronte prirjes së përgjithshme të kësaj gjuhe për të thjeshtuar fleksionin e përcaktorëvet, sidomos kur këta përdorshin pas emrave (shih për këtë edhe vërejtjet e mia në «St. fil.» 2, 1973, §§ 70-73). Ky proces thjeshtimi në paradigmën e pronorëvet ishte i pashmangshëm edhe për arsye se ajo ishte tepër e ndërlikuar me forma, që po bëheshin gjithnjë e më të pakuptueshme për ndjenjën gjuhësore popullore. Në rrethana të tilla nuk mund të mos gjente fushë të lirë veprimi rrafshues i analogjisë, e cila ka luajtur një rol të madh në thjeshtimin e fleksionit të pronorëvet. Në disa raste, si p.sh. në mënjanimin e plotë të formave të vjetra të rasës rrjedhore për vetën e parë e të dytë, njëjës e shumës (si: *sim*, *sinë*, *sit*, *sij* < *si* + *u* + *j*, *sāj* < *sa* + *u* + *j*), veprimi rrafshues i analogjisë është mundësuar edhe nga prirja e përgjithshme e shqipes së re për të zëvendësuar tek emrat format e rrjedhore me ato të dhanores (shih «St. fil.» 2, 1973, § 42). Edhe në mënjanimin e pjesshëm ose të plotë të formave të gjinisë asnjëse (*tim/tem*, *tanë*, *tat*, *taj* < *ta* + *u* + *j*) veprimi rrafshues i analogjisë është mundësuar gjithashtu nga prirja e përgjithshme e shqipes për të mënjanuar gradualisht gjininë asnjëse edhe në sistemin emëror (shih për këtë Sh. Demiraj, Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe, 192 v.).

E paqartë mbetet përse gjuha ka mënjanuar format e shumësit maskullor *yj* (< *y* + *u* + *j*) dhe *taj* (< *ta* + *u* + *j*) (shih për këto forma S. Riza, BUSHT, SShSh 3, 1959, 13), duke i zëvendësuar ato me format e gjinisë femërore *juaj/juej* (< *jo* + *u* + *j*) dhe *tuaj/tuej* (< *to* + *u* + *j*). (shih për këto forma Jokl, IF 49, 275 v.). Kurse ndikimi analogjik i formave të rasave emërore e kallëzore në mënjanimin, përkatësisht në formimin e disa formave rasash të tjera është plotësisht i kuptueshëm, po të kemi parasysh dëndurinë e madhe të përdorimit të këtyre dy rasave. Këtu është fjala për shtrirjen analogjike, përkatësisht ndikimin analogjik, të disa formave rasore edhe në rasta të tjera, si p.sh. për shtrirjen analogjike të formës së kallëzores së vetës së dytë njëjës *tënd* edhe në rasta gjindore, dhanore e rrjedhore (duke zëvendësuar kështu format e vjetra *tit/tyt*, *sit*). Të kihet parasysh edhe riformimi analogjik i dhanores dhe kallëzores femërore të pronorit të vetës së parë shumës *sonë* (< *sanë*), *tonë* (< *tanë/tënë*) në ndikimin e emërores *jonë*, si edhe shtrirja e formës *tonë* edhe në paradigmën e gjinisë maskullore në vend të formave më të vjetra të gjindore-dhanores, kallëzores e rrjedhore (*tinë*, *tanë/tënë* dhe *sinë*).

70. Gjatë këtyre shekujve të fundit pronorët *im* / *ime*, *yt* / *jote*, *ynë* / *jonë* dhe *juaj*, në rasën emërore, kanë ardhur duke u përdorur gjithnjë e më shumë, kryesisht në të folmet geqe, me «nyje të përparme» (si p.sh. *i em* / *i im*, *i jonë*, *i juaj* etj.). Shtimi i «nyjes së përparme» të këto forma pronorësh është bërë, me sa duket, në ndikimin analogjik të mbiemrave të nyjshëm dhe të formave të pronorëvet *e mi*, *e tu* (shih për këto §§ 14-15, 22), si edhe të gjindores së emrave, që del rregullisht e paranyjzuar dhe që takohet me pronorët në funksionin e përkatësisë.

Ndryshe e shpjegon S. Riza (BUSHT, SShSh 3, 1959, 20, 24) këtë «riformim analogjik» të pronorëvet në shqyrtim. Sipas tij (po aty, f. 24), «ky rinyjzim i

këtyre pronorëve në këtë rasë [në rasën emërore — Sh.D.] do të kishte qenë kryekëput i pamundshëm, sikur shqipfolësi në gegërishten e re këta pronorë të mos i kishte ndjerë të **nyjshëm me nyja të vëna edhe në rasat e zhdrejta**, e për pasojë sikur ai këta pronorë të mos i kishte analizuar kështu:

djalin	T'anë	vajzën	T'onë
djalit	T'anë	vajzës	S'onë
(djali	I ynë)	(vajza	E jonë)»

Ky shpjegim më duket i pambështetur, për arsye se format e rasavet të zhdrejta të pronorëvet në përgjithësi ishin bërë prej kohësh të paanalizueshme në ndjenjën gjuhësore popullore. Edhe sikur të pranohej e kundërta, ndarje të tilla si *T'anë, T'onë, S'onë*, që i atribuohen ndjenjës gjuhësore popullore, nuk gjejmë mbështetje në realitetin gjuhësor të kohës, kur është shfaqur dukuria e paranyjzimit të pronorëvet; në atë kohë (më drejt: në asnjë kohë) *-anë, -onë* nuk kanë ekzistuar të shkëputura nga bashkëtingëllorja nistore (*t-, s-*), prandaj nuk kishte arsye që ndjenja gjuhësore popullore t'i interpretonte format e tipit *tanë, tonë, sonë* etj. si *t'anë, t'onë, s'onë*.

71. Siç u vu në dukje në § 63, edhe përemrat e pacaktuar *kushdo* dhe *cilido* (fem. *cilado*) lakojnë elementin e tyre të parë. Këta bëjnë pjesë në grupin e përemrave të pacaktuar, që kanë si element të dytë fjalëzën e ngurosur *-do*, e cila e ka burimin tek forma e vetës së tretë njëjës të së tashmes (dëftore) të foljes *dua*⁴⁵. Në këtë grup, siç dihet, hyjnë edhe përemrat e pacaktuar të palakueshëm *çdo*⁴⁶ dhe *çfarëdo*. Me këtë grup bashkohen, për nga tipi strukturor, edhe ndajfoljet përemërore *kudo, ngado, tekdo, kurdo* (herë) si edhe lidhëza *sado* (me origjinë ndajfoljore).

Përemrat e pacaktuar të tipit në shqyrtim janë formuar nëpërmjet njëfjalëzimit të dy gjymtyrëvet kryesore të një fjalie përcaktore lidhore të pazgjëruar, të përdorur në ndërtime të tipit: Këtë e bën *kush do* (= *kush dëshiron*). Nga ndërtime të këtij tipi nuk ishte e vështirë të arrihej në ndërtime të tipit: Këtë e bën *kushdo*. Në bazë të këtij shpjegimi, njëfjalëzimi i dy gjymtyrëve (*kush do > kushdo*,

45) Të ngjashëm, por jo të njëjtë, për nga tipi strukturor, me këta përemra të shqipes janë edhe përemrat e pacaktuar të latinishtes *quivis (quaevis, quidvis)* dhe *quilibet (quaelibet, quidlibet)* «*kushdo (cilido, cilado, çfarëdo)*», ku elementi i parë është një përemër, kurse elementi i dytë është folja *vis «do»* (veta e dytë njëjës), përkatësisht *libet «pëlqen»* (veta e tretë njëjës), Shih M. Domi, vep. cit. 32/1. A. Ernout, Morphologie historique du latin, 157.

Një ngjashmëri më e madhe, për nga tipi strukturor, ekziston midis këtyre përemrave të shqipes dhe përemrave të pacaktuar të rumanishtes *çineva, careva, ceva* etj., ku elementi i parë është një përemër lidhor i pacaktuar dhe elementi i dytë (*-va*) veta e tretë njëjës e foljes *dua*. Por, për nga kuptimi, këta u përgjigjen përemrave të shqipes *ndokush, ndonjë* etj. Në kuptimin e përemrave të pacaktuar të tipit *kushdo* në rumanishte përdoren përemrat e përngjitur *oricine, oricare* etj. ku folja *ori «do»* është elementi i parë i foljes së përngjitur ashtu si tek *n-da-kush* etj. (Shih për këto K. Sandfeld, Linguistique balkanique, 128; M. Domi, vep. cit. 32/1; E. Çabej, «Revue Roumaine de Linguistique» 1-3 (1965), 108-109).

46) Ky përemër sot përdoret me kuptim distributiv, si sinonim me *secili*. Por tek Buzuku ai përdoret kryesisht me kuptimin e përemrit *disa*. P.sh.

cili do > cilido) duhet të ketë ndodhur në fjali përcaktore lidhore, ku përemri *kush* (a *cili* ka qenë në rasën emërore (në funksion kryefjalor). Format e rasavet të zhdrejta (*kujtdo, këdo; cilitdo, cilindo, cilësdo, cilëndo*), pas gjithë gjasash, janë rindërtime analogjike sipas formavet rasore të vetë përemrit *kush*, përkatësisht *cili*.

72. Siç del edhe nga sa u shtjellua në paragrafët e mëparshëm, lakimi i përemravet — me ruajtjen e pjesëshme të disa tipareve arkaike të trashëguara, me ndikimin e fortë nga lakimi emëror dhe mbiemëror dhe, më në fund, me përfitim e disa tipareve të reja të një lakimi *sui generis* — është një pasqyrë e qartë e evolucionit të madh të vetë sistemit përemëror të gjuhës shqipe, i cili siç u vu në dukje edhe në § 1, është transformuar dhe riorganizuar pothuaj krejtësisht gjatë rrymës së shekujvet. Një evolucion i tillë, për nga përmasat dhe përfundimet, mund të krahasohet vetëm me atë që ka pësuar sistemi foljor (i shqipes), i cili paraqitet gjithashtu pothuaj krejt i riorganizuar në krahasim me tipin e vjetër indoevropian. Evolucionit të sistemit heterogjen të lakimit përemëror në gjuhën shqipe në një masë të konsiderueshme e gjen shpjegimin e vet, ashtu siç u vu në dukje edhe në paragrafët e mëparshëm, tek ndikimi i fuqishëm, që ka ushtruar lakimi i emravet dhe i mbiemravet. Ky ndikim është përfutur jo vetëm tek ata përemra, që përnga tipi strukturor kanë ngjashmi me emrat dhe mbiemrat, por edhe tek ata që kanë pasur në zanafillë një strukturë të ndryshme prej këtyre të fundit, siç kanë qenë përemrat vetorë, dëftorë dhe pyetës (si p.sh. tek format *me-je, te-je, so-je, ne-ve, ju-ve, ne-sh, ju-sh, ku-jt*). Ndikimi i lakimit emëror dhe mbiemëror mbi atë të përemravet është plotësisht i kuptueshëm, po të kihet parasysh lidhja kuptimore dhe ngjashmia e madhe funksionale e këtyre të fundit pjesërisht me klasën e emravet, pjesërisht me atë të mbiemravet.

Por evolucionit të sistemit heterogjen të lakimit përemëror e ka burimin edhe në faktin e njohur që përemrat e ndryshëm të shqipes nuk përbëjnë një klasë fjalësh homogjene për nga mosha dhe tipi strukturor. Në këtë klasë fjalësh, siç dihet, krahas një numri të kufizuar përemrash të vjetër, ku ruhen ende disa tipare arkaike të trashëguara (me evolucionet tingëllore përkatëse), janë krijuar gjatë etapash të ndryshme të zhvillimit të shqipes një numër relativisht më i madh përemrash të tjerë, të cilët si për nga tipi strukturor ashtu edhe për nga tipi i lakimit pasqyrojnë gjendjen e gjuhës shqipe në kohën e krijimit të tyre. E nga kjo pikëpamje sqarimi historik i klasës heterogjene të përemravet të shqipes është me rëndësi të madhe për ndriçimin e historisë së kësaj gjuhe.

E hinje *zhdo* ñ. shkruosëshit thoshnë ndë vetëhenë... «Ed ecce quidam de scribis dixerunt intra se...»

Edhe në vepërzën e Matrëngës gjejmë të përdorur me të njëjtin kuptim përemrin e pacaktuar *çëdo* (në kopjen e parë të dorëshkrimit shkruar si *çado*, kurse në dy kopjet e tjera shkruar *çë do*): ... e i shtonenë *çëdo* fjalë të shejtsë Elisabettë e të klishtësë. «... al che s'aiungono alcune parole di santa Elisabetta et della chiesa.» (shih fol. 22 ose fol. 59, përkatësisht 78, të kopjes I, përkatësisht 2, 3 të veprës së Matrëngës në botimin e M. Sciambra-s, f. 41, përkatësisht f. 115, 167).

Për këtë fjalë shih edhe E. Çabej «St. fil.» 3, 1968, 109.

R é s u m é

LES TRAITS DE LA FLEXION DANS LE SYSTEME PRONOMINAL DE L'ALBANAIS

Dans cet article, l'auteur a voulu tirer au clair certaines questions concernant :

- 1) Les traits archaïques dans la flexion de certains pronoms hérités.
- 2) L'influence de la flexion des substantifs et des adjectifs sur la flexion de certains pronoms.
- 3) Les nouveaux traits dans la flexion de certains pronoms engendrés au cours de l'évolution historique de l'albanais (§§ 1-2).

I

On doit considérer comme traits archaïques: 1) les formes supplétives caractérisant la flexion du pronom personnel de la première personne sing. (*u-në, mua, me-je*) et celles des démonstratifs *a-i, a-jo, a-ta* ou bien *k-y, k-jo, kë-ta*. (p.ex. *a-i, a-ti-j, a-të, a-si* etc.). 2) L'alternance vocalique dans la flexion des pronoms personnels *m-ua : m-e-je; n-a : n-e; t-i : t-y; t-e-je*; 3) L'alternance vocalique *-u- : -ë* et la présence de la désinence *-sh* dans la flexion du pronom interrogatif *kush* (cfr. *ku-sh, ku-jt, kë*) (§§ 3-4).

Puis l'auteur s'occupe en détail de toutes ces formes. En voici sommairement ses points de vue:

Pour ce qui est de l'opposition *u-në : mua, me-je, u-* (*-në* est, comme l'on sait, un *élargissement relativement récent*) n'est pas emprunté au latin (§ 6), mais il tire son origine du pronom réfléchi *°sue* (§ 7), tandis que *mua, me-je* appartiennent au thème pronominal i.e. en *m-*. Au même thème appartient également le possessif *mi* (à présent, *e mi*), qui, d'après l'auteur, est un ancien génitif du pronom personnel de la première personne (§ 8).

Mua / mue (chez Buzuku et Budi *muo*) est le réflexe de l'ancien accusatif *°mō -n* <i.e. *°mē-m*. L'emploi de *mua / mue* même en fonction de datif est postérieur au passage de l'ancien génitif-datif *mi* dans la classe des possessifs. D'après l'auteur, *mi* est ou bien le réflexe albanais de l'ancien génitif-datif i.e. *°moi* (*°mei*), ou bien le réflexe d'un ancien datif *°me-i* (à cfr. avec le datif des substantifs du type *djal-i*). L'opinion de Camarda et de S. Riza qui la font dériver d'un pluriel *°im-í*, est insoutenable (§§ 14-15).

Me- (dans *me-je*) doit son origine, vraisemblablement, à l'ancienne forme i.e. *me-*. L'opinion de G. Meyer la faisant dériver de *°moi*, comme celle de M. Domi et de I. Ajeti qui la font dériver de *°mō -*, sont insoutenables (§§ 11-13).

Pour ce qui est de l'opposition *na : ne*, l'explication de Meyer qui fait remonter *na* à une ancienne forme du nominatif *°nōs*, et *ne* à une ancienne forme de l'accusatif *°nōs* (§§ 16-17), n'est pas inadmissible. Mais même l'opinion de Jokl (IJ, XII, 150) qui fait dériver *në* de *nae* (*na* + l'ancienne désinence *e* du gén. dat. pl.) ne semble pas moins probable.

Aux formes *ti, ty, te-je* du pronom personnel de la deuxième personne on doit relier de même le possessif *tu* (à présent: *e tu*), qui a été, à l'origine, un ancien génitif du pronom personnel. Les alternances vocaliques *-u- : -y : -i-* sont dûes à l'évolution interne de l'albanais. La forme du nominatif *ti* est le réflexe de l'i.e. *tā*, à travers *tȳ*, comme Meyer l'a bien expliqué. La conservation de la forme *tȳ* pour l'accusatif-datif est due, vraisemblablement, au besoin de la faire distinguer du nom. *ti*, comme E. Çabej l'a bien mis en évidence. La critique de Çabej contre Pedersen qui fait dériver, *ty* de *°tve*, est bien fondée. L'auteur se rallie à l'opinion de Çabej qui fait dériver *tȳ* de *tā*, mais il ne lui semble pas nécessaire que *-ā* ait été dans une position non-finale, comme Çabej souligne (§§ 18-20).

Le possessif *tu* (à présent, *e tu*) a été à l'origine (comme *mi*, v. ci-dessus), un ancien génitif du pronom personnel comme Bopp l'a bien expliqué. L'absence de l'évolution \bar{a} : \bar{y} est due, vraisemblablement, au fait que les possessifs sont généralement moins accentués et ainsi l' \bar{a} a perdu graduellement sa quantité primitive (§ 22).

Te- (dans *te-je*) est, peut-être, le réflexe de l'i.e. $^{\circ}te-$. Cependant même l'opinion de Meyer, la faisant dériver de $^{\circ}teu$, n'est pas inadmissible (§ 23).

*
* *
*

Quant au paradigme compliqué des démonstratifs *a-i*, *a-j-o*, *a-ta*, respectivement *k-y*, *k-j-o*, *kē-ta*, l'auteur approuve les critiques de Pedersen contre G. Meyer qui rattache les diverses formes de ce paradigme à trois thèmes pronominaux différents (§§ 26-27). Il admet, en général, la théorie de Pedersen qui rattache tout ce paradigme au démonstratif i.e. $^{\circ}so$, $^{\circ}sā$, $^{\circ}tod$, mais il présente également plusieurs réserves et critiques. Il admet sans réserve l'explication de Pedersen pour les formes casuelles *a-j-o*, *a-ta* (neutre sing.), *a-tē* < *a-ta* (acc. sing., masc. et fém.) *a-ti-j* (dat. sing. masc.) et *a-to* (plur. fém. et neutre), qui ont évolué respectivement de $sā > hā > o$; $tod > ta$; ton (masc.) > $tan > tα > tē - tān$ (fém.) > $tα > tē$; tei 11; $tās$ (fém.) $to - tā$ (neutre) > to (§§ 30-35).

Pour les autres formes du paradigme l'auteur présente les objections suivantes:

1. On peut admettre que la variante *-y* (*a-y*) du nom. sing. masc. est plus ancienne que *-i* (*a-i*), parce que l'évolution \bar{u} : y : i est phonétiquement plus plausible. Mais le rattachement de *-y* à *so* soulève des difficultés, surtout pour ce qui est de l'alternance o : u ($^{\circ}so > ho > u$). L'affirmation de Pedersen (Festschrift t. V. Thomsen, 252) que cette évolution est due à la position finale de la voyelle, est insoutenable. Toutefois, on peut supposer que cette alternance se soit produite à travers l'ultérieure vélarisation de o en u sous l'influence de l'*h* précédent. Il reste à expliquer aussi la longueur de l'*u*, dont Pedersen ne fait aucune mention. La quantité de cette voyelle est due, vraisemblablement, au fait que les démonstratifs ont été fortement accentués (§§ 36-37).

2. Les formes en *s-*: *a-si*, *a-sa-j*, *a-so*, *a-si-sh*, *a-so-sh*, que Pedersen fait dériver respectivement de $^{\circ}tojēi$, $^{\circ}tojāi$, $^{\circ}tojā$, $^{\circ}tojēisu$, $^{\circ}tojāsu$, soulèvent également des difficultés de caractère phonétique. L'évolution $tj-$: *s-* est bien plausible, mais on ne pourrait pas expliquer la chute prétendue de l'*-o-* de la première syllabe. En outre, on devrait expliquer aussi l'origine de *-j* dans toutes ces formes ainsi que l'évolution $\bar{a}i$: *a* dans la forme reconstruite $tojāi > sa$ (a *-sa-j*).

Il est plus probable que les formes en *s-* (*a-si*, *a-sa-j*, *a-so*) doivent leur origine à la contamination des paradigmes des démonstratifs so , $^{\circ}sa$, $^{\circ}tod$ et $^{\circ}t(i)jo$, $^{\circ}tjo$, comme Brugmann semble avoir supposé. Les formes du pluriel *a-si-sh*, *a-so-sh* semblent être reconstruites par l'addition de la désinence casuelle *-sh* des substantifs aux formes casuelles pronominales *a-si*, *a-so* du singulier (§§ 38.41).

Même *ta* (*a-ta*) du pluriel (nom. et acc.) masc. ne saurait être rattaché à $^{\circ}toi$ ou $^{\circ}tons$, comme Pedersen le voulait. La diphtongue *-oi* à la position finale ne pouvait pas aboutir à *-a*. Il semble que *-oi* finale ait abouti à *-i* (L'auteur renvoie à son livre Questions du système nominal. . . , 112 sq.). D'une autre opinion est E. Çabej («St. fil.» 2, 1970, 81) qui n'admet que l'évolution oi : ai : *a*. D'autre part, $^{\circ}tons$ de l'acc. pl. aurait abouti à $tē$, au moins, dans les parlers de l'Albanie du Sud. Donc, il semble plus probable que *ta* (*a-ta*) du pl. masc. soit le réflexe de $to-$ (forme de l'acc. pl. après la chute antérieure la désinence *-ns*) (§§ 42-44).

La forme *tyne* / *tyre* (du gén. datif. pl.), que Pedersen fait dériver de $^{\circ}tōn$ avec l'addition postérieure de *-e* du gén. plur. des subst., est également difficile à expliquer. Il faut éclaircir, en premier lieu, l'évolution o : $-y-$, qui n'a rien de semblable dans la phonétique historique de

l'albanais. En outre, il est improbable que *-on* soit reflété par *-o* dans les substantifs et par *-yn-* (*-yr*) dans les démonstratifs. D'autre part, l'opinion de Skok faisant dériver *tyne* de deux formes pronominales (*ty + ne*) est insoutenable (§ 45).

Pour ce qui est du pronom interrogatif *kush*, il faut tirer au clair plusieurs questions. Tout d'abord, il faut démontrer que ce mot n'est pas un emprunt latin, comme Meyer le voulait. A, ce propos, on peut souscrire à l'opinion de Pedersen qui le rattachait au pronom interrogatif i.e. *°kuo*. Mais il reste à préciser encore la forme primitive reflétée par *ku-* du nom.- dat. (*ku-sh*, *ku-i-t*). *-sh* doit être le réflexe d'une désinence ancienne, qui s'est trouvée dans une position non-finale, comme Çabej a bien précisé («St. fil.» 1, 1964, 90). *-i-* et *-t* (dans *ku-i-t*) sont la désinence, respectivement l'article, du datif (des substantifs masculins). La forme *kē* (geg. *kē*) est le réflexe de *kan* < i.e. *°quom* ~ *°kom*. *kē* du guègue s'est reformé à date relativement récente, d'après le démonstratif *atē*, qui est également secondaire. L'opinion de Jokl considérant *kē* plus ancien de *kā* (en guègue) est privée de fondement; chez Buzuku on a: *kana*, *askana*, *gjithë-kana* etc. (§§ 47-50).

II

L'influence de la flexion nominale sur celle de certains pronoms est bien compréhensible, si l'on tient compte de l'étroit lien sémantique existant entre ces deux classes de mots ainsi que du parallélisme presque complet dans leurs fonctions. Cette influence a été exercée soit directement soit indirectement à travers la flexion des adjectifs.

L'influence directe de la flexion des substantifs sur celle de certains pronoms consiste dans le passage de quelques désinences casuelles des substantifs aux pronoms. Telles sont:

1. *-je* des substantifs féminins (p. ex. *re-je* etc.) dans les formes pronominales *me-je*, *te-je*, *so-je*, *se-je* (chez Buzuku *se-i*, avec la désinence *-i* du dat. -abl. masc.) (§ 52);
2. *-ve*, *-sh* dans les formes pronominales *ne-ve*, *ne-sh*, *ju-ve*, *ju-sh*, *si-sh*, *so-sh*, *ca-ve*, *disa-ve*, *të gjithë-ve*, *të tërë-ve*, *shumë-ve*, *pakë-ve*, *të tjerë-ve*, *së tjerë-sh* (*së tjera-sh*) etc. (§ 53).
3. *-i-t* dans *ku-jt* (§ 54).
4. La flexion des pronoms interrogatifs *cili*, *cila* et relatif *i cili*, *e cila* et reconstruite d'après la flexion définie des substantifs masculins et féminins, tels que *guri*, *fusha*. Mais on peut supposer ici une influence indirecte à travers la flexion définie des adjectifs substantivés du type *i miri*, *e mira* (§ 55).

*
* *

L'influence indirecte de la flexion des substantifs à travers celle des adjectifs paraît encore plus claire dans la flexion des pronoms possessifs employés substantivement (p.ex. *im-i*, *tim-it*, *tim-in*, etc.), ainsi que du pronom indéfini *tjetër* (employé au défini et à l'indéfini) (§ 56).

* *

L'influence directe de la flexion des adjectifs est frappante dans la flexion du démonstratif *i tillë* / *e tillë* (*i kë tillë* / *e kë tillë*), des possessifs *i tij* / *e tij*, *i saj* / *e saj*, *i tyre* / *e tyre*, *e mi*, *e tu*, ainsi que des interrogatifs *i sejtë* / *e sejtë*, *i sati* / *e sata* et du relatif *i cili* / *e cila*, tous ces pronoms étant pré-articulés comme les adjectifs du type *i mirë* / *e mirë* (§§ 57-62).

III

De nouveaux traits se sont produits dans la flexion des pronoms possessifs du type *im* ainsi que des indéfinis du type *kushdo* et *cilido* qui se sont engendrés, tous, au cours de l'évolution historique de l'albanais. Dans ces pronoms qui sont composés de deux éléments agglutinés, c'est le premier élément qui se décline. Il s'agit d'une flexion *sui generis*, tout à fait différente de l'ancien type i.e. Un pareil type de flexion n'est pas inconnu même à d'autres langues i.e. comme le grec ancien, le latin etc. (§ 63).

Dans les possessifs *im* / *ime* (à l'exception de la forme du pluriel *e mi* / *e mia*), *ynë* / *jonë*, *yt* / *jote* (à l'exception de la forme du pluriel *e tu* / *e tua*) et *yj* / *juaj*, le premier élément s'accorde avec le substantif, désignant la « possession », en genre, en nombre et en cas, parfaitement comme il arrive à « l'article antéposé » des adjectifs dits articulés. Le premier élément (un ancien démonstratif, selon Bopp etc., un ancien article, selon Pedersen etc.) de ces possessifs a conservé, donc, l'indépendance formelle héritée du temps, où il n'était pas encore agglutiné au deuxième élément (un ancien pronom personnel, d'après Bopp etc., un ancien possessif, d'après Pedersen etc.). Ce phénomène a été favorisé par le fait que le deuxième élément a été, vraisemblablement, indéclinable et par l'autre fait que le premier a été un élément accentué (§§ 64-65).

L'absence du préfixe *a-/kë-* dans le premier élément, la conservation de la désinence *-n* du premier élément dans la forme de l'accus. *tan-d* et l'alternance *-a-* : *-ë-* dans les parlers tosqes (*tën-d*), la réduction des anciennes diphtongues *-au-* : *-a-*, *-yu-* : *-y-*, *-iu-* : *-i-* dans les formes anciennes *taj*, *tij*, *saj*, *sij* (respectivement de ^o*tauj*, ^o*tiuj*, ^o*sauj*, ^o*siuj*), ainsi que l'accentuation du premier élément, tous ces faits témoignent en faveur d'une ancienneté relativement reculée des possessifs en question. Mais l'absence du rhotacisme dans les formes *ynë*, *jonë*, *tanë*, *ton-a* et de la réduction *-a-* : *-ë-* dans la forme *tanë* témoigneraient du contraire. En de telles circonstances, on peut supposer que la soudure des deux éléments des possessifs en question se soit accomplie après que la loi du rhotacisme/et/ celle de la réduction *a:ë* devant les nasales ont cessé d'agir dans les parlers tosqes (§ 66).

Donc, les possessifs de l'albanais ne sont pas homogènes du point de vue structural. On peut en distinguer trois types appartenant à trois couches différentes. Les plus anciennes sont les formes *mi*, *tu* (à présent *e mi*, *e tu*), dont on a fait mention plus haut. Les formes agglutinées (telles *im*, *ynë* etc.) sont relativement moins anciennes, tandis que les formes *i tij*, *i saj*, *i tyne* / *i tyre*, *i vet*, sont les plus récentes (§§ 67-68).

Au cours de l'évolution historique de l'albanais, surtout pendant les quatre derniers siècles, le paradigme assez compliqué des possessifs agglutinés s'est dégagé de plusieurs formes devenues peu à peu archaïques. La simplification de ce paradigme compliqué est le résultat direct de la tendance générale de l'albanais à réduire les formes des cas, ce qui a laissé le champ libre à l'action de l'analogie (§ 69).

*

* * *

Pour ce qui est des indéfinis du type *kushdo* et *cilido*, comparables aux indéfinis du latin (tels *quivis* et *quilibet*) et surtout du roumain (tels *cineva*, *careva*, *ceva*), ils se sont engendrés à travers l'univerbation des deux termes principaux d'une proposition subordonnée sujet, employée dans les phrases du type *Këtë e bën kush do* = . . . celui qui veut., d'où il n'était pas difficile à aboutir à *Këitë e bën kushdo* (v. § 71).

A la fin, l'auteur relève les conclusions principales de l'article.

